



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 14

Tiranë – E martë, 10 shkurt 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 65, datë 28.1.2015	Për miratimin e protokollit për bashkëpunimin për zhvillim, 2014-2016, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë..... 529
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 28.1.2015	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit..... 537
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 76, datë 28.1.2015	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë, të aneksit të godinës me emërtimin “Ish-Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika”, Korçë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 530, datë 7.8.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar..... 547
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 28.1.2015	Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale..... 548
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr. 1, datë 27.1.2015	Për certifikimin e kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore..... 549
Udhëzim i ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 10, datë 26.1.2015	Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara..... 550
Udhëzim i ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 17, datë 28.1.2015	Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e nënkontraktimit të së drejtës së lejes minerare, për kërkim-zbulim, për shfrytëzim apo për kërkim- zbulim-shfrytëzim..... 551
Urdhër i ministrit të Financave nr. 9, datë 29.1.2015	Për delegim kompetence..... 553

Vendim i Gjykatës Kushtetuese
nr. 4, datë 2.2.2015

Me objekt: 1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet qeverisjes vendore: Bashkia e Tiranës, bashkia e Krujës, komuna Katund i Ri, dhe pushtetit qendror: Këshilli i Ministrave/Këshilli Kombëtar i Territorit.

2. Shqyrtimi i pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe me Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore, si dhe shfuqizimi si antikushtetues, si akte që bëhen shkak për lindje të konfliktit, i vendimeve nr. 1, datë 8.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në disa zona me rëndësi kombëtare dhe procedurën e hartimit të Planit të Integruar Sektorial për Brezin Bregdetar” dhe nr. 3, datë 18.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në zonën me rëndësi të veçantë të Kurores së Tiranës”.

3. Pezullimin e vendimeve nr. 1, datë 8.10.2013 dhe nr. 3, datë 18.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Kushtetuese.....

554

Kërkesë e ministrit të Transportit
dhe Infrastrukturës
nr. 705, datë 30.1.2015

Për shpronësim publik për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Hidrocentrali i Banjës-Gramsh dhe Ura e Tashovicës".....

562

Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Sami Muharremi....

565

**VENDIM****Nr. 65, datë 28.1.2015**

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT
PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM,
2014-2016, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË ITALISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit për bashkëpunimin për zhvillim, 2014 - 2016, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

PROTOKOLLI

**PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË
2014-2016**

Përpyekja për një botë më të drejtë e më të barabartë, në të cilën “Të mirat globale publike”, të tilla si paqja, drejtësia, zhvillimi ekonomik, mjedisi, njohuritë dhe ndihma humanitare garantohen për të gjitha qeniet njerëzore, është mes atyre parimeve frymëzuese të politikës së jashtme italiane dhe veprimeve të saj të jashtme (Kooperacioni Italian për Zhvillim– Udhëzime trevjeçare 2014-2016).

I. PARATHËNIE

Partneriteti ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë është i fuqishëm e jetëgjatë, dhe bazohet në marrëdhëniet e jashtëzakonshme historike, kulturore dhe ekonomike.

Kooperacioni Italian për Zhvillim (KIZH) ka qenë i pranishëm në Shqipëri që në vitin 1991, në mbështetje të zhvillimit shoqëror-ekonomik të

vendit përmes programeve që synonin konsolidimin e sistemeve të prodhimit, për lidhjen me rrjetet rajonale të infrastrukturës, nxitjen e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, së bashku me ato shoqërore, arsimore dhe shëndetësore.

Italia ka qenë dhe ende përfaqëson një partner të privilegjuar për Shqipërinë: është një prej donatorëve kryesorë bilateralë gjatë më shumë se njëzet vjetëve të fundit, vendi mikpritës i njërit prej komuniteteve më të mëdha shqiptare të emigrantëve jashtë shtetit, partneri i parë komercial dhe kryesor i IHD-së shqiptare. Për më tepër, Italia ka qenë gjithnjë në krye për sa i përket ndihmës për qeverinë shqiptare gjatë tranzicionit drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut të hapur, deri tani, duke prezantuar një mbështetje të fuqishme për integrimin e Shqipërisë në BE.

Angazhimi politik i Italisë në Shqipëri reflektohet edhe në strategjinë më të gjerë të qeverisë italiane në Ballkanin Perëndimor, e cila synon nxitjen dhe qëndrueshmërinë e politikës së zgjerimit të BE-së, duke rrënjësuar brenda saj vlerat demokratike dhe mundësitë e siguruara në lidhje me kultivimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Për më tepër, Shqipëria konsiderohet si një vend prioritar në rajon, për shkak të vendndodhjes strategjike gjeopolitike dhe pozitës së saj pajtuese dhe stabilizuese që ka treguar me vendet fqinje në aspektin më të gjerë të Rajonit Makro-Adriatiko-Jonian të BE-së. Dialogu midis qeverive të Italisë dhe Shqipërisë është i qëndrueshëm dhe i fuqishëm dhe është mbështetur me anë të marrëdhënive të thella bashkëpunuese bilaterale në mjaft sektorë dhe fusha. Duke u bazuar në këtë aspekt, qeveritë e Shqipërisë dhe Italisë kanë rënë dakord për një Protokoll të ri Bashkëpunimi për Zhvillim për periudhën 2014-2016.

Vizioni i përbashkët në të cilin fokusohet edhe Protokollin i ri për Bashkëpunimin për Zhvillim është ai i rritjes së integruar, të shpejtë, të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të mirëqeverisur, e cila synon në krijimin e një pasurie dhe mirëqenieje më të madhe për një Shqipëri evropiane.

Për këtë qëllim, qeveria italiane synon të caktojë një shumë të përgjithshme prej 81.7 milionë euro për periudhën 2014-2016. Kjo paketë përfshin edhe instrumentet e mëposhtme financiare: i) kredi të buta e të lidhura, të mbetura nga Protokollin i



Bashkëpunimit për Zhvillim (PBZH) 2002-2004; ii) kredi të reja të buta e të palidhura, sipas rregullave të OBZHE-së (Marrëveshja mbi udhëzimet për kreditë e eksportit të mbështetura zyrtarisht -neni 36-a); iii) një fazë të re të programit të konvertimit të borxhit, dhe iv) një komponent granti.

II. KONTEKSTI ZHVILLIMOR NË SHQIPËRI

Shqipëria është një vend me të ardhura të mesme të larta (PBB 4,090 USD për frymë¹) me një nivel mesatarisht të lartë papunësie (13% - FMN: 2013). Ajo zë vendin e 70-të nga 187 vende dhe territore², me një vlerë prej 0.749, që përbën edhe vlerën e 5-të më të ulët mes vendeve evropiane, pas Moldavisë, Bosnjë-Hercegovinës, Maqedonisë dhe Ukrainës³. Që nga viti 1991, Shqipëria ka përjetuar një tranzicion të shpejtë drejt tregut dhe ka pësuar një rritje të konsiderueshme të PBB-së (mbi 6% në pesë vjet deri në vitin 2008), por që ende nuk i arrin standardet e BE-së në disa fusha, të tilla si konkurrenca ekonomike, përfshirja sociale, konsolidimi i shtetit ligjor, qëndrueshmëria mjedisore dhe infrastrukturat fizike. Që prej vitit 2009 dhe me shpërthimin e krizës globale ekonomike dhe financiare, ekonomia shqiptare ka ruajtur një rritje pozitive, por të kufizuar: rritja e PBB-së shënoi një zbritje të lehtë nga 3.3% në vitin 2009 në 1.6% në vitin 2012.

Shqipëria ka nënshkruar një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi (MSA) në vitin 2006 dhe ka dorëzuar formalisht aplikimin për anëtarësim në BE në vitin 2009. Në vitin 2012 Komisioni Evropian rekomandoi që Shqipërisë t'i jepet statusi i vendit kandidat të BE-së, në varësi të përmbushjes së masave kryesore në fushat e reformës gjyqësore dhe administratës publike, si edhe rishikimit të rregullave të procedurës së parlamentit. Që atëherë, Shqipëria ka bërë hapa të konsiderueshëm dhe të qëndrueshëm përpara në rrugën e saj drejt integritimit në BE, siç edhe është konstatuar në Raportin e Komisionit Evropian të qershorit 2014. Për këto arsye, Italia përshëndet dhënien e statusit kandidat të Shqipërisë në BE. Që nga viti 2005, Qeveria e Shqipërisë (QSH) ka marrë një rol gjithnjë e më të madh udhëheqës në koordinimin e ndihmës së huaj. Sistemi i

Planifikimit të Integruar (SPI), me mbështetjen e Komitetit Ndërkombëtar, përbën edhe mekanizmin operacional që siguron efikasitetin dhe konformitetin e politikës së qeverisë, planifikimit, buxhetit dhe proceseve monitoruese. Departamenti i Programit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj (DPZHFNH) pranë Këshillit të Ministrave ka mandatin për koordinimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) që përbën edhe kuadrin kombëtar strategjik afatmesëm-afatgjatë, i cili udhëheq procesin e bashkërendimit dhe harmonizimit të Partnerëve për Zhvillim dhe Integrim (PZHI). SKZHI-ja zbatohet nëpërmjet Programeve Buxhetore Afatmesme, të cilat përfshijnë projektimet për fondet kombëtare dhe ato donatorë të zbatimit të strategjive. Për më tepër, në mbështetje të mandatit të saj shumë-aspektësh të planifikimit strategjik, analizimit të politikave, monitorimit, vlerësimit dhe koordinimit të donatorëve, DPZHFNH-ja udhëheq edhe hartimin dhe zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Ndihmën e Huaj.

Shqipëria ka një strukturë të mirë qeveritare për koordinimin e donatorëve në vend. Sektorët kryesorë të zhvillimit pasqyrohen me anë të grupeve sektoriale specifike të punës, që bashkojnë ministratë përkatëse dhe donatorët aktivë, nën udhëheqjen e zyrës qeveritare për koordinimin e donatorëve. Donatorët organizohen nëpërmjet Sekretariatit Teknik të Donatorëve, i cili përfshin përfaqësues të Komisionit Evropian, Bankës Botërore, OSBE-së, PNUD-it, së bashku me donatorët bilateralë. Takimet koordinuese me institucionet ndërkombëtare financiare, si edhe me donatorët e BE-së dhe ata jo të BE-së, organizohen rregullisht. Ato fokusohen kryesisht në planifikimin e politikës kombëtare dhe mekanizmit monitorues, të tilla si orientimet strategjike të Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe dimensionet rajonale të planifikimit dhe programimit të Instrumentit të Para-anëtarësimit të BE-së (IPA).

Si Italia, ashtu edhe Shqipëria janë të përkushtuara që të mbështesin e të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e harmonizimit të donatorëve dhe bashkërendimit të ndihmës, duke zbatuar tërësisht parimet e përcaktuara me anë të Rezolutës së Monterreit (mars 2002), theksuar më tej me anë të Deklaratës pasuese të Romës mbi Harmonizimin (shkurt 2003), Deklaratës së Parisit

¹BB, 2013.

²Indeksi i Zhvillimit Njerëzor, 2012, PNUD.

³IZHNJ 2013, PNUD.



mbi Efikasitetin e Ndihmës (mars 2005), Agjendës së Akrës për Veprim (shtator 2008) dhe Partneritetit të Busanit për Zhvillim (dhjetor 2011).

Si lehtësuese e Nismës Pista e Shpejtë mbi Ndarjen e Punës së BE-së për Shqipërinë, Italia e ka ndihmuar Qeverinë e Shqipërisë në ndërmarrjen e kësaj iniciative (FT-DoL). Në vitin 2010 është pranuar dhe nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi (MM) ndërmjet qeverisë shqiptare dhe komunitetit të donatorëve të BE-së, që përcakton edhe donatorët kryesorë për secilin sektor. Italia u caktua si donator kryesor në zhvillimin e sektorit privat, dhe u njoh edhe si kontribuuesi përkatës dhe donatori aktiv në sektorin e zhvillimit shoqëror (punësimi/AFP, barazia gjinore, përfshirja sociale, shëndetësia dhe arsimi) dhe atë të zhvillimit bujqësor e rural.

III. MËSIMET E NXJERRA

Ndihma Zyrtare Italiane për Zhvillim (NZIZH) ka disbursuar në Shqipëri një shumë prej rreth 700 milionë euro, të investuar në vend që në fillim të viteve '90 me qëllimin e përballimit të emergjencave të këtyre viteve, në mbështetje të modernizimit të infrastrukturave publike, promovimit të demokratizimit dhe fuqizimit institucional, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm shoqëro-ekonomike, dhe në vitet e fundit, duke shoqëruar integrimin e vendit në BE.

Protokolli Dypalësh i Bashkëpunimit për Zhvillim (PDBZH) 2002-2004, i nënshkruar në prill të vitit 2002, financoi një numër të gjerë programesh të cilat fokusoheshin në zhvillimin shoqëro-ekonomike dhe infrastrukturat publike. Sektorët e ndërhyrjes përfshinin energjinë, transportin, infrastrukturat dhe furnizimin me ujë, por edhe zhvillimin e sektorit privat, bujqësinë, arsimin, shëndetësinë, infrastrukturat bazë shoqërore dhe kapacitetin institucional. Një portofol kaq i gjerë dhe i fragmentuar ka kërkuar kosto të mëdha menaxhimi për asistencë teknike të lartë dhe të vazhdueshme dhe procese të zgjatura procedurale. Duke mbajtur parasysh këtë, Protokolli Dypalësh i Bashkëpunimit për Zhvillim (PDBZH) 2010-2012 është përqendruar në tri sektorë kryesorë: zhvillimin e sektorit privat, bujqësinë dhe zhvillimin rural e shoqëror ndërsa miratohet strategjia dalëse nga sektorët e tjerë.

Përvoja e fituar gjatë këtyre viteve dhe rekomandimet e vitit 2014 të vlerësimit të partne-rëve të OBZHE-së/BNZH mbi bashkëpunimin

italian inkurajon mbështetjen e mëtejshme mbi bazën e praktikave më të mira dhe në fushat specifike dhe të ndërlidhura, me qëllimin e krijimit të efekteve të shumëfishta të ndikimit të programeve dhe optimizimit të përpjekjeve të përbashkëta të bashkëpunimit për zhvillim. Pranohet, po ashtu, edhe nevoja e strukturimit të proceseve të hartimit dhe disbursimit më efektive nga pikëpamja kohore se më parë.

KIZH-ja njeh rëndësinë e ndihmës së shpejtë dhe agjendën e zhvillimit efektiv. Pronësia vendore dhe pozicionimi janë parime bazë për garantimin e qëndrueshmërisë dhe ndikimit, ashtu siç janë edhe përdorimi i sistemeve të vendit dhe harmonizimi, të cilat synojnë në zvogëlimin e kostove të transaksionit dhe përpjekjeve të dyfishta mes iniciativave të donatorëve. Përgjegjësia e përbashkët përforcon transparencën, qeverisjen dhe efikasitetin. Në këtë aspekt, Programi Italo-Shqiptar i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim (KBZH) konsiderohet si praktika më e mirë, jo vetëm për arsye të lidhjes dhe miratimit nga ana e tij të parimeve të efikasitetit të Ndihmës dhe Zhvillimit, por edhe për fleksibilitetin, shpejtësinë dhe efektet zinxhir të zhvillimit të kapaciteteve. Rrjedhimisht, iniciativat e ardhme të KIZH-së në Shqipëri do të miratojnë modalitetet e zbatimit në përputhje me objektivat dhe strategjitë e zhvillimit, programet dhe procedurat e rëna dakord me qeverinë shqiptare dhe komunitetin e donatorëve.⁴ Në këtë pikë, do të inkurajohet më tej harmonizimi me donatorët e tjerë, veçanërisht përmes Komisionit Evropian, mundësisht mes programimit të përbashkët, bashkëpunimit të deleguar dhe mekanizmave të kombinuar financues. Do të promovohen gjithashtu edhe qasjet me bazë të gjerë sektoriale dhe programore.

KIZH-ja do të aplikojë modalitete të menaxhimit bazuar në rezultate, për zbatimin e Programit të Vedit, si edhe procese të përbashkëta monitorimi dhe vlerësimi, bazuar në sistemet e vendit. Që prej vitit 2005, QSH-ja ka pasur një progres të jashtëzakonshëm në lidhje me treguesit e ndryshëm të efektivitetit të ndihmës, siç janë fuqizimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe zvogëlimi i strukturave paralele të zbatimit të projekteve. Me prezantimin e një sistemi gjithëpërfshirës të thesarit

⁴I bëhet referencë Sekretariatit Teknik të Donatorëve dhe takimev të PZHI-së.



dhe përmirësimeve në fushat e prokurimit, auditimit të brendshëm e të jashtëm, dhe ngritjes së një Sistemi të qëndrueshëm Menaxhimi Informacioni për regjistrimin e financimeve të donatorëve, përmbushen kushtet kryesore të Menaxhimit Financiar Publik, duke i krijuar mundësinë donatorëve të përdorin tërësisht sistemet e QSH-së gjatë ciklit të menaxhimit të projektit.

Italia njihet rolin e rëndësishëm të organizatave joqeveritare italiane dhe shqiptare (OJQ-ve) në inkurajimin e pronësisë demokratike të aktorëve vendorë zhvillimorë, në mbështetjen e rrjeteve sociale apo partnere, promovimin e rolit dhe pjesëmarrjes së të gjitha palëve shoqërore dhe politike, të cilët mbështesin dhe garantojnë zhvillimin, qeverisjen e mirë dhe demokratizimin. Për më tepër, Italia njihet dialogun konstruktiv që përfshin rajonet italiane dhe autoritetet vendore që veprojnë në Shqipëri, të cilat garantojnë një vlerë të shtuar në mbështetje të kohezionit territorial dhe forcimit të procesit aktual të decentralizimit në vend.

Në përgjithësi, si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë dhe afatgjatë ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë në një grup të gjerë sektorësh, mjaft aktorë të të ashtuquajturit “Sistema Italia” tashmë janë të pranishëm në vend, duke përfshirë edhe përfaqësuesit nga OJQ/OSHC, sektori privat, fusha akademike dhe autoritetet italiane vendore. KIZH-ja do të promovojë fuqishëm një partneritet përfshirës mes institucioneve të ndryshme të dy vendeve, do të stimulojë mes niveleve të ndryshme të angazhimit italian, dhe do të inkurajojë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj vendit në praktikën e bashkëpunimit për sigurimin e një koherence efektive të politikës për zhvillim.

IV. PRIORITETET STRATEGJIKE TË BASHKËPUNIMIT BILATERAL

Bazuar në procesin e konsultimit të ndërmarrë në fund të vitit 2013, i cili mori në konsideratë përvojën e kaluar, prioritetet dhe objektivat kombëtarë zhvillimorë, parimet efektive të ndihmës dhe zhvillimit dhe ndarjes së punëve mes donatorëve, autoritetet shqiptare dhe italiane ranë dakord që Protokollin e Bashkëpunimit për Zhvillim për vitet 2014-2016 të adresojë kryesisht komponentët e mëposhtëm kryesorë dhe prioritetet strategjike të SKZHI-së:

a) Zhvillim i qëndrueshëm nëpërmjet përmirësimit të konkurrueshmërisë dhe përdorimit efikas të burimeve, duke pasur parasysh veçanërisht forcimin e konkurrueshmërisë dhe inovacionit për rritjen në sektorët kryesorë ekonomikë, duke përfshirë bujqësinë dhe zhvillimin rural. Për më tepër, fondet e konsiderueshme të mbetura, sërish në dispozicion nga PBZH 2002-2004 lejojnë mbështetjen shtesë të infrastrukturës për zhvillim në lidhje me energjinë, ujin dhe kanalizimet. Megjithatë, është pranuar se KIZH-ja po tërhiqet nga mbështetja e drejtpërdrejtë për zhvillimin e infrastrukturës.

b) Investimi në njerëz dhe kohezionin social do të fokusohet kryesisht në zhvillimin e burimeve njerëzore, përfshirjen sociale dhe veprimet për kohezionin territorial. Kjo shtyllë do të adresohet edhe më tej nëpërmjet një çështjeje tjetër: 1) Programin e konvertimit të borxhit. Ky instrument rezultoi të ishte tejet fleksibël, efektiv dhe reagues ndaj prioritetëve të zhvillimit shoqëror dhe nevojave vendore, duke nxitur zhvillimin e burimeve njerëzore, përfshirjen dhe kohezionin social, barazinë gjinore, duke mbështetur pronësinë dhe fuqizimin e kapaciteteve të autoriteteve vendore. Për më tepër, burime të reja do të caktohen në mbështetje të: 2) Trajnimit dhe formimit profesional (TFP) për të përfshirë më mirë nevojat e tregut në perspektivën e të nxëniet gjatë gjithë jetës.

c) Qeverisja e mirë, demokracia dhe shteti ligjor. Të dyja palët e pranojnë vlerën e parimeve evropiane të subsidiaritetit dhe afërsisë në mundësimin e shërbimeve nga sektori publik. Duke pasur këtë parasysh, KIZH-ja do të mbështesë reformën territoriale administrative të qeverisë shqiptare, në proces zbatimi, me qëllimin konsolidimin e Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) drejt decentralizimit më të gjerë rregullator e fiskal dhe fuqizimit të autonomisë vendore. Tashmë njihet rëndësia që procesi i reformës territoriale administrative ndjek standardet ndërkombëtare për objektivitetin analitik, transparencën dhe gjithëpërfshirjen. Mbështetja e KIZH-së ndaj reformës shqiptare territoriale administrative do të përdorë mekanizmat e fondeve të përbashkëta shumë-donatorësh.

Duke ndjekur iniciativat e bashkëpunimit të zbatuara gjatë viteve të fundit, po ashtu, KIZH-ja trajton edhe çështjet themelore ndërsektoriale në të



gjitha fushat e ndërhyrjes të përmendura më sipër. Të drejtat e njeriut, demokracia, paqja dhe siguria, shteti ligjor, barazia gjinore dhe fuqizimi i grave, mbrojtja e pakicave dhe grupeve të rrezikuara, përfshirja sociale e personave me aftësi të kufizuara, mbrojtja e mjedisit, trashëgimia kulturore dhe zhvillimi i kapaciteteve janë çështje që Italia i integron në nivelin ndërkombëtar. Këto vlera politike dhe morale, të ndërfutura në politikën e jashtme italiane, janë parakushte themelore mbi të cilat Italia ka ndërtuar partneritetin e saj me Shqipërinë.

KIZH-ja do të punojë në disa çështje ndër sektoriale, si barazia gjinore dhe fuqizimi i grave; përfshirja sociale e personave me aftësi të kufizuara, pakicave dhe grupeve të rrezikuara; mbrojtja e mjedisit; dhe lufta kundër korrupsionit, të cilat pengojnë qeverisjen e mirë, dobësojnë reagimin e administratës publike dhe përkeqësojnë përgjegjshmërinë dhe integritetin institucional. KIZH-ja do të punojë për këto çështje duke i integruar ato nëpër fushat kryesore dhe sektorët prioritarë, ose duke përdorur fondet e përbashkëta shumë-donatorësh.

V. NDËRHYRJET SEKTORIALE PËR PERIUdhËN 2014- 2016

Qeveritë e Shqipërisë dhe Italisë ranë dakord në lidhje me nevojën e hartimit të Protokollit të Bashkëpunimit për Zhvillim, i cili mbulon periudhën 2014 – 2016 për zbatimin e objektivave, udhëzimeve dhe prioriteteve të përcaktuara më sipër.

Hartimi i PBZH 2014 - 2016 i është caktuar Ambasadës Italiane në Tiranë – Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim (ZBZH), nën mbikëqyrjen dhe koordinimin e Ambasadorit Italian dhe të Drejtorisë së Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim (DPBZH) të Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar. Hartimi i PBZH-së është bërë duke marrë në konsideratë rezultatet dhe përvojën e fituar gjatë PBZH-ve të mëparshme. Gjatë procesit përgatitor të protokollit të bashkëpunimit 2014 -2016, UTL në Tiranë ka ruajtur dialog të vazhdueshëm me autoritetet shqiptare përkatëse (Departamentin e Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj-pranë Këshillit të Ministrave dhe ministritë përkatëse të linjës).

a) Zhvillimi i Qëndrueshëm nëpërmjet përmirësimit të konkurrueshmërisë dhe përdorimit eficient të burimeve

a.1 Konkurrueshmëria dhe inovacioni për rritjen

1. Zhvillimi ekonomik me fokus të veçantë në nxitjen e IHD/IND të reja.

KIZH-ja është në pararojë të mbështetjes së konkurrueshmërisë, inovacionit, cilësisë dhe krijimtarisë në sektorin privat, dhe fuqizimit të ndërmarrjeve të vogla & të mesme (NVM) në veçanti, një fushë ku Italia luan rolin e donatorit kryesor mes anëtarëve të Bashkimit Evropian. Ky fokus do të fuqizohet në tri vitet e ardhme me 20 milionë euro të tjera për një program që synon nxitjen e IHD/IND të reja në Shqipëri. Objektivat kryesorë të këtij programi do të jenë: (i) ngritja dhe financimi i një “Skeme mbështetëse e Programit” për iniciativat e projekteve të biznesit në sektorët potencialë për rritje të lartë/strategjikë; (ii) mbështetja për qeverinë shqiptare në themelimin e “Agjencisë së pjesëmarrjes”, në fazën e saj fillestare, për zbatimin e skemave të financimit; (iii) mbështetja e aktiviteteve dhe veprimeve për nxitjen e të ashtuquajturve “Mundësues për investime”.

Shpërndarja e fondeve: 20 milionë euro (kredi e butë). Modalitetet e programit do të përcaktohen në marrëveshjeje ndërmjet palëve. Institucionet kryesore referuese për programin do të jenë Zyra e Kryeministrit/Njësia e Investimeve Strategjike dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

2. Bujqësia dhe zhvillimi rural me fokus të veçantë në mbështetjen e iniciativave që synojnë rritjen ekonomike/punësimin dhe të sistemeve produktive në sektor.

Italia ka qenë gjithnjë një donator i fuqishëm dhe aktiv në këtë sektor dhe aktualisht po e mbështet procesin e integritetit të Shqipërisë në BE duke lehtësuar ndryshimet legislative në përputhje me *acquis communautaire* në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe duke fuqizuar kapacitetet e qeverisë shqiptare në zbatimin e politikave përkatëse. Përvoja dhe rezultatet e arritura do të fuqizohen më tej në tri vitet e ardhme me 5 milionë euro për një program që synon financimin e iniciativave të biznesit, të cilat stimulojnë IHD/IND në sektorin e bujqësisë dhe/apo iniciativat e biznesit që përkthehen në zhvillim ekonomik. Në fokus do të jenë, po ashtu, edhe fuqizimi i zinxhirëve të prodhimit,



standardeve të sigurisë ushqimore dhe organizimit të fermerëve.

Shpërndarja e fondeve: 5 milionë euro (kredi e butë). Modalitetet e programit do të përcaktohen në marrëveshje me palëve. Institucioni kryesor referues për programin do të jetë Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

3. Programi i asistencës teknike

Shpërndarja e fondeve: 2.4 milionë euro (grant) për mundësimin e asistencës teknike për menaxhimin e programeve të zhvillimit ekonomik (duke përfshirë bujqësinë dhe zhvillimin rural, si edhe programet e grave në sipërmarrje). Institucionet kryesore referuese për programin do të jenë Kryeministria/Njësia e Investimeve Strategjike, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Komponenti i grantit përfshin, po ashtu, edhe një komponent për zhvillimin e grave në sipërmarrje.

a.2 Infrastruktura për zhvillim

4. Energjia. Që në fillim të aktivitetit në vend, KIZH-ja ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në stabilizimin e sektorit shqiptar të energjisë elektrike. Programet që synonin përmirësimin e kapaciteteve të menaxhimit dhe qëndrueshmërinë e sektorit, duke mbështetur operatorët elektrikë shqiptarë, në drejtim të fuqizimit strukturor të sistemit shqiptar të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe integritetit të tij në rrjetin rajonal Ballkani. Me fondet e mbetura nga PBZH 2002-2004, KIZH-ja do të financojë më tej: i) projekte rehabilitimi; ii) ngritjen e kapaciteteve dhe veprimtaritë e transferimit të njohurive.

Shpërndarja e fondeve: 16.2 milionë euro (kredi e butë e mbetur nga PBZH 2002-2004) bashkë me fondet e mundshme të mbetura nga kontratat në zbatim. Modalitetet e programit do të përcaktohen në marrëveshje me palëve. Institucioni kryesor referues për programin do të jetë Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

5. Uji dhe kanalizimet. KIZH-ja ka financuar programe të rëndësishme për përmirësimin e shërbimeve të integruara të ujit, sistemeve të shpërndarjes, furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit dhe të trajtimit të kanalizimeve të zonës së gjerë urbane të Tiranës. Për shkak të fondeve të mbetura nga PBZH 2002-2004, KIZH-ja do të financojë më tej një program infrastrukture

për furnizimin me ujë, grumbullimin dhe trajtimin e kanalizimeve në zonat prioritare që do të identifikohen bashkërisht.

Shpërndarja e fondeve: 10.5 milionë euro (kredi e butë e mbetur nga PBZH 2002-2004). Modalitetet e programit do të përcaktohen në marrëveshje me palëve. Institucioni kryesor referues për programin do të jetë Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

b) Investimi në njerëz dhe kohezioni social

6. Programi i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim. Që në konceptimin e tij gjatë fazës së parë, Programi IADSA përmbushi parimet më të avancuara të zhvillimit efektiv (p.sh. pozicionimit, menaxhimit mbi bazë rezultatesh, harmonizimit dhe përgjegjshmërisë) duke mbështetur iniciativat e zhvillimit shoqëror të promovuara nga institucionet publike shqiptare në nivel kombëtar dhe vendor, me qëllim fuqizimin e kohezionit social mbi baza territoriale, zhvillimin e balancuar rajonal, barazinë sociale dhe krijimin e vendeve të punës në mbështetje të Shqipërisë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Faza e dytë e programit do të mbështetet në praktikën më të mira dhe rezultatet e arritura deri tani, duke investuar më tej në zhvillimin e burimeve njerëzore, punësimin, nxitjen e barazisë gjinore, rritjes së kohezionit social, me fokus të veçantë tek të rinjtë e papunë, gratë në nevojë, pakicat dhe personat me aftësi të kufizuara dhe mbështetjen e mbrojtjes sociale për grupet e rrezikuara.

Shpërndarja e fondeve: 20 milionë euro. Modalitetet e programit do të përcaktohen në marrëveshje me palëve. Institucioni kryesor referues për programin do të jetë Ministria e Financave.

7. Arsimi dhe formimi profesional përmes inovacionit. Programi i financuar nga KZHI-ja do të fokusohet specifikisht në mbështetjen e zgjerimit të një shoqërie të bazuar në njohuri të avancuara në përpunime me kërkesat e tregut të punës për thithjen e IHD/IND në sektorët produktivë, ku Shqipëria paraqet potencial të madh dhe ku Italia përbën një vlerë të rëndësishme të shtuar (p.sh. turizmi, moda, mobilia, përpunimi i ushqimeve bujqësore, etj...).

Shpërndarja e fondeve: 5 milionë euro (kredi e butë). Modalitetet e programit do të përcaktohen në marrëveshje me palëve. Institucionet kryesore referuese për programin do të jenë Ministria e Rinisë dhe Mirëqenies Sociale dhe



Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratës Publike.

c) Qeverisja e mirë, demokracia dhe shteti ligjor

8. Reforma territoriale dhe antikorrupsioni. KIZH-ja do të mbështesë reformën territoriale administrative dhe luftën kundër korrupsionit përmes kontributit financiar në fondin e përbashkët shumëdonatorësh.

Shpërndarja e fondeve: 0.8 milionë euro (grant). Institucioni kryesor referues për programin do të jetë ministri i Shtetit për Çështjet Vendore.

d) Menaxhimi i Programit dhe Monitorimi për Rezultate

9. Menaxhimi i programit dhe monitorimi për rezultate, asistenca teknike dhe kostot operacionale për zbatimin e programit të vendit.

Shpërndarja e fondeve: 1.8 milionë euro (grant). Institucion kryesor referues për menaxhimin e programit dhe monitorimin për rezultate do të jetë Zyra e Kryeministrit/Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj.

VI. INICIATIVAT E FINANCUARA JASHTË PROTOKOLLIT PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM

Modalitetet financiare dhe kanalet e KIZH-it parashikojnë fonde specifike për OJQ-të/OSHC-të dhe organizatat ndërkombëtare të programuara mbi baza vjetore. Financimet e KIZH-së për këto synime do të jetë përtej financimeve të specifikuara në këtë protokoll. Për më tepër, KIZH-ja në të gjithë angazhimet e tij do të synojë të rrisë koherencën në financimin dhe bashkëpunimin me projektet e OJQ-ve dhe autoritetet vendore italiane (bashkëpunimi i decentralizuar).

VII. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Në përputhje me parimet e efektivitetit të ndihmës për zhvillim dhe rekomandimet e OECD-DAC për veprim të bashkëpunimit për zhvillim, të dyja palët do të zbatojnë parimet e menaxhimit mbi bazën e rezultateve, në përpjekjen e tyre të përbashkët për të arritur një përdorim efektiv dhe eficient të burimeve, për të treguar ndikimin, arritjet dhe progresin e programeve dhe, si përfundim, të jenë të përgjegjshëm përpara qytetarëve përkatës dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Për këtë qëllim, brenda gjashtë muajve nga nënshkrimi, palët do të krijojnë një kuadër monitorimi dhe vlerësimi, dhe një Sistem të Menaxhimit të Njohurive të rëndësishëm për këtë protokoll në mënyrë që të përfitojnë nga përvoja, për të informuar nivelet vendim marrëse dhe forcimin e kapaciteteve. Kur është e mundur, Palët do të shqyrtojnë mundësitë e përfshirjes së sistemeve të vendit për të matur rezultatet, produktet dhe përmbushjen e veprimeve. Bazuar në rezultatet e arritura, Palët do të miratojnë masa të posaçme për të lehtësuar dobësitë pikat e dobëta apo të metat e mundshme.

VIII. SHPËRNDARJA E BURIMEVE TË PROTOKOLLIT PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM 2014 - 2016

Qeveria italiane, në bazë të ligjit mbi Buxhetin e Shtetit për vitet 2014 dhe 2016, do të vërë në dispozicion një paketë prej 81.7 milionë euro për zbatimin e këtij Protokollit për Bashkëpunimin për Zhvillim 2014 -2016.

Detajet në lidhje me sektorët e identifikuar, shpërndarjen indikative të burimeve (vlerat e sakta do të identifikohen në fund të ushtrimeve vlerësuese), dhe kanalet financiare që do të përdoren janë përcaktuar në tabelën e mëposhtme:



PROTOKOLLI PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM 2014-2016

SEKTORI	REZULTATET E PRITSHME TË SEKTORIT	PROGRAMET	INSTITUCIONI SHQIPTAR	INSTRUMENTI FINANCIAR	SASIA NË EURO
a.RRITJA E QËNDRUESHME PËRMES PËRMIRËSIMIT TË KOMKURRUESHMERISË DHE PËRDORIMIT EFIÇENT TË BURIMEVE					
<i>a.1 Konkurrueshmëria dhe inovacioni për zhvillim</i>					
Zhvillimi ekonomik	Rritja e IHD/IND, promovimi i investimeve në teknologji	Për t'u identifikuar	ZKM/Njësia e Investimeve Strategjike dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Kredi e butë	20
Bujqësia dhe zhvillimi rural	Forcimi i një prodhimi ushqimor të qëndrueshëm dhe cilësor duke zhvilluar një sektor agro-ushqimor konkurrues dhe novatore	Për t'u identifikuar	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Kredi e butë	5
Programi i Asistencës Teknike	Zhvillimi i IHD/IND në sektorët kyç, nxitja e investimeve në teknologji, sipërmarrjen e grave	Asistenca teknike dhe shërbimet mbështetëse; fuqizimi i rolit të grave	KiM/DPZHFNH dhe ministrinë përkatëse	Grant	2.4
<i>a.2 Infrastruktura për zhvillim</i>					
Energjia	Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në të gjithë sektorët; Zvogëlimi i humbjeve në shpërndarjen e energjisë elektrike	Projekte rehabilituese; ngritja e kapaciteteve dhe transferimi i njohurive	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Kredi e butë (fonde tepriçë AID 6656)	16.2
Uji dhe kanalizimet	Zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve	Furnizimi me ujë dhe mbledhja e ujërave të zeza e trajtimi	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Kredi e butë (fonde tepriçë AID 6345)	10.5
b.I INVESTIMI NË NJERËZ DHE KOHEZIONIN SOCIAL					
Konvertimi i Borxhit për Zhvillim⁵	Arsimi, AFP, Punësimi dhe Përfshirja Sociale, Mbrojtja Sociale	Marrëveshja Italo-Shqiptare për Konvertimin e Borxhit (IADSA)	Ministria e Financave	Konvertim borxhi	20
AFP	Forcimi iAFP-së për tregun e punës, nëpërmjet iniciativave novatore	Për t'u identifikuar	Ministria e Mirëqenies Sociale Ministri i Inovacionit dhe Administratës Publike	Kredi e butë	5
c. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI LIGJOR					
Qeverisja e mirë dhe decentralizimi	Decentralizimi dhe reforma territoriale antikorrupsioni	Mbështetje për reformën territoriale administrative (PNUD-STAR); antikorrupsioni	Ministri për Çështjet Vendore	Grant	0.8
d.MENAXHIMI I PROGRAMIT DHE MONITORIMI PËR REZULTATE					
Monitorimi për Rezultate, Asistenca Teknike	Programi në Vend zbatohet me efikasitet	Përgatitja e programit, menaxhimi dhe monitorimi për rezultate	-	Grant	1.8
TOTALI					81.7
KREDI E BUTË					30
KREDI E BUTË TEPRICË					26.7
KONVERTIMI I BORXHIT					20
GRANT					5

Firmosur në Tiranë më:.....2014, në dy origjinale

⁵ Programi i Konvertimit të Borxhit do t'i nënshtrohen miratimit nga Ministrinë Italiane të Ekonomisë dhe Financave.

**VENDIM****Nr. 66, datë 28.1.2015****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
MALIT TË ZI, PËR NJOHJEN E
NDËRSJELLË TË LEJEVE TË
DREJTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE**NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT
TË ZI MBI NJOHJEN E NDËRSJELLË TË
LEJEVE TË DREJTIMIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi (më poshtë të quajtura "Palë kontraktuese", me qëllim përmirësimin e sigurisë së transportit rrugor, si dhe lehtësimin e qarkullimit rrugor në territoret e Palëve kontraktuese, kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Palët kontraktuese njohin reciprokisht konvertimin e lejeve të rregullta të drejtimit të lëshuara nga autoritetet kompetente të palës tjetër kontraktuese, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, në favor të mbajtësve të lejeve të drejtimit të cilëve u është dhënë leja e qëndrimit ose e qëndrimit të përkohshëm në territoret e tyre.

Palët kontraktuese njohin gjithashtu, për qëllime qarkullimi në territoret e tyre, lejet kombëtare të drejtimit, të lëshuara nga pala tjetër kontraktuese brenda periudhës së vlefshmërisë së tyre.

Neni 2

Leja e drejtimit, e lëshuar nga një prej autoriteteve të palëve kontraktuese, pushon së qenuri e vlefshme për qëllim qarkullimin në territorin e palës tjetër kontraktuese, pas një viti nga data e dhënies së lejes së qëndrimit ose qëndrimit të përkohshëm mbajtësit të saj në territorin e palës tjetër kontraktuese.

Neni 3

Në interpretim të neneve të kësaj marrëveshjeje, termi "qëndrim" dhe "qëndrim i përkohshëm" ka kuptimin e përcaktuar dhe të rregulluar nga legjislacioni përkatës i brendshëm në fuqi i palëve kontraktuese.

Neni 4

Nëse një mbajtësi të lejeve të drejtimit të lëshuara nga një prej autoriteteve të palëve kontraktuese i është dhënë leja e qëndrimit ose qëndrimit të përkohshëm në territorin e palës tjetër kontraktuese, ata do të konvertojnë lejet e tyre të drejtimit pa iu nënshtruar provimeve teorike dhe praktike.

Autoritetet kompetente kërkojnë një certifikatë mjekësore, e cila vërteton se një person ka kaluar provimin e cilësive psiko-fizike të kërkuara për kategorinë specifike.

Për zbatimin e paragrafit të parë të këtij neni, mbajtësi i lejes së drejtimit duhet të ketë moshën e parashikuar nga legjislacionet përkatëse të brendshme të palëve kontraktuese për lëshimin e kategorisë për të cilën kërkon konvertimin.

Neni 5

Konvertimi i lejeve të drejtimit të Republikës së Shqipërisë të hartuara sipas modelit prej letre në fuqi që nga 1 nëntori 1999, do të lejohet për periudhën prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Për këto leje drejtimi është e nevojshme që në çdo rast të kërkohet një certifikatë, e përmendur në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje, e cila provon vlefshmërinë e tyre.

Neni 6

Në kohën e konvertimit të lejeve të drejtimit, kategoritë e barasvlershme të lejeve të drejtimit të palëve kontraktuese, njihen në bazë të tabelave teknike të barasvlershmërisë që i bashkëlidhen kësaj marrëveshjeje tek e cila janë pjesë përbërëse. Këto tabela dhe një listë e modeleve të lejeve të drejtimit përbëjnë shtojcat teknike që mund të ndryshohen me anë të një njoftimi me shkrim ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese.

Autoritetet qendrore kompetente për konvertimin dhe verifikimin e lejeve të drejtimit janë si më poshtë:

a) në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës-Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;

b) në Malin e Zi, Ministria e Brendshme-Departamenti për Çështjet e Brendshme Administrative.

Palët kontraktuese përdorin gjuhën angleze në zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe gjithashtu mund të bien dakord mbi përdorimin e gjuhëve të tjera për komunikim.

Neni 7

Gjatë procedurës së konvertimit të lejeve të drejtimit, autoritetet kompetente të palëve kontraktuese tërheqin lejet që duhet të konvertohen dhe ua kthejnë autoriteteve kompetente të palës tjetër kontraktuese, së bashku me një listë të këtyre lejeve dhe një njoftim.

Neni 8

Autoritetet kompetente të secilës prej palëve kontraktuese që vlerëson përmbushjen e kushteve për konvertimin e lejes së drejtimit, kërkon përkthimin zyrtar të lejes së drejtimit. Ky autoritet kërkon informacion nga autoritetet kompetente të palës tjetër kontraktuese në lidhje me vlefshmërinë e lejes së drejtimit dhe të dhënave të treguara në të.

Informacioni i konvertimit kryhet nëpërmjet telefaksit, duke përdorur modelin e "kërkesës" dhe të "certifikatës së vlefshmërisë së lejes së drejtimit",

bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje. Kërkesa dhe certifikata përbën një shtojcë teknike që mund të ndryshohet nga autoritetet kompetente të palëve kontraktuese me anë të një njoftimi me shkrim.

Të dhënat i dërgohen drejtpërdrejt autoritetit kompetent të palës kontraktuese kërkuese.

Neni 9

Autoriteti qendror kompetent i një pale kontraktuese, që merr lejen e drejtimit të tërhequr pas konvertimit, njofton autoritetin qendror kompetent të palës tjetër kontraktuese nëse dokumenti përmban parregullsi në lidhje me vlefshmërinë dhe të dhënat e treguara në të.

Neni 10

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike që konfirmon se palët kontraktuese kanë përmbushur të gjitha procedurat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj.

Kjo marrëveshje do të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund ta denoncojë këtë marrëveshje në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, denoncimi do të hyjë në fuqi pas gjashtë muajsh nga data e marrjes së këtij njoftimi.

Çdo konflikt në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me anë të konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet palëve kontraktuese.

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me miratim të ndërsjellë me shkrim të palëve kontraktuese. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

Bërë në Tiranë më 15 dhjetor 2014, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.



SHTOJCA I

Mali i Zi
Ministria e Brendshme
Departamenti për Çështjet e Brendshme Administrative
Faks: 0038220203275

Republika e Shqipërisë
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
Faks: 0035542238175

ÇERTIFIKATË VLEFESHMËRIE E LEJES SË DREJTIMIT

NR. _____

Lutemi informohuni se leja e drejtimit me numër _____ është e rregullt dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

A. Të dhëna të mbajtësit të lejes së drejtimit

- Emri: _____
- Mbiemri: _____
- Datëlindja: _____
- Vendlindja: _____
- Data e lëshimit: _____
- Data e skadimit: _____
- Numri i lejes: _____
- Kategoritë: _____
- Adresa: _____

B. Kërkesa të tjera të detyrueshme : (për shembull, protezë akustike e detyrueshme etj.):

C. Leja e drejtimit është lëshuar* / nuk është lëshuar* nga konvertimi i një lejeje tjetër të huaj të lëshuar nga:

VENDI DHE DATA

VULA DHE FIRMA E NËNPUNËSIT

(*) me përjashtim të rastit që nuk është i zbatueshëm.



Republika e Shqipërisë
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
Faks: 0035542238175

Mali i Zi
Ministria e Brendshme
Departamenti për Çështjet e
Brendshme Administrative
Faks: 0038220203275

ÇERTIFIKATË VLEFSHIMËRIE E LEJES SË DREJTIMIT

NR. _____

Lutemi informohuni se leja e drejtimit me numër _____ është e rregullt dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

A. Të dhëna të mbajtësit të lejes së drejtimit

- Emri: _____
- Mbiemri: _____
- Datëlindja: _____
- Vendlindja: _____
- Data e lëshimit: _____
- Data e skadimit: _____
- Numri i lejes: _____
- Kategoritë: _____
- Adresa: _____

B. Kërkesa të tjera të detyrueshme : (për shembull, protezë akustike e detyrueshme etj.):

C. Leja e drejtimit është lëshuar* / nuk është lëshuar* nga konvertimi i një lejeje tjetër të huaj të lëshuar nga:

VENDI DHE DATA

VULA DHE FIRMA E NËNPUNËSIT

(*) me përjashtim të rastit që nuk është i zbatueshëm.



SHITOJCA 2

Mali i Zi
Ministria e Brendshme
Departamenti për Çështjet e Brendshme Administrative
Faks: 0038220203275

Republika e Shqipërisë
Ministria e Transportit dhe
Infrastrukturës
Drejtoria e Përgjithshme të
Shërbimeve të Transportit Krugor
Faks: 0035542238175

KËRKESË
PËR KONFIRMIMIN E VLEFSHMËRISË SË LEJES SË DREJTIMIT
NR. _____

Lutemi informohuni se leja e drejtimit me numër _____ është e rregullt dhe
përmban të dhënat e mëposhtme:

A. Të dhëna të mbajtësit të lejes së drejtimit

- Emri: _____
- Mbiemri: _____
- Datëlindja: _____
- Vendlindja: _____
- Data e lëshimit: _____
- Data e skadimit: _____
- Numri i lejes: _____
- Kategoritë: _____
- Adresa: _____

Bashkëlidhur fotokopja e lejes së drejtimit

VENDI DHE DATA

VULA DHE FIRMA E NËNPUNËSIT



Republika e Shqipërisë
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
Faks: 0035542238175

Mali i Zi
Ministria e Brendshme
Departamenti për Çështjet e
Brendshme Administrative
Faks: 0038220203275

KËRKESË
PËR KONFIRMIMIN E VLEFSHMËRISË SË LEJES SË DREJTIMIT
NR. _____

Lutemi informohuni se leja e drejtimit me numër _____ është e rregullt dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

A. Të dhëna të mbajtësit të lejes së drejtimit

- Emri: _____
- Mbiemri: _____
- Datëlindja: _____
- Vendlindja: _____
- Data e lëshimit: _____
- Data e skadimit: _____
- Numri i lejes: _____
- Kategoritë: _____
- Adresa: _____

Bashkëlidhur fotokopja e lejes së drejtimit

VENDI DHE DATA

VULA DHE FIRMA E NËNPUNËSIT



SHTOJCA 3

LEJET E DREJTIMIT TË LËSHUARA NË MALIN E ZI

I Lejet e drejtimit të lëshuara deri më 7 janar 2013

A, B, C, D, E

II Lejet e drejtimit të lëshuara që nga 7 janari 2013

AM, A1, A2, A, B1, B, B+E, C1, C1+E, C, C+E, D1, D1+E, D, D+E, T.

Personave të cilët kanë fituar më parë të drejtën për të operuar kategori të caktuara, do t'u lëshohet një leje drejtimi për kategoritë e mëposhtme:

- 1) A - A, A1, A2, T dhe AM;
- 2) B - B, B1, B+E, T dhe AM;
- 3) C - C, C1, B, B1, B+E, T dhe AM;
- 4) D - D, D1, C, C1, B, B1, B+E, T dhe AM;
- 5) certifikatë e njohurive të rregulloreve - T dhe AM;
- 6) C, D dhe E - B+E, C+E, C1+E, D+E, D1+E;
- 7) C dhe E - B+E, C+E, C1+E;
- 8) B dhe E - B+E.


SHTOJCA 4

MODELET E LEJEVE TË DREJTIMIT TË LËSHUARA NË MALIN E ZI

- I. Modeli i lejes së drejtimit, me dy faqe, rozë, prodhuar me material të veçantë, i lëshuar deri më 9 maj 2008



- II. Modeli i lejes së drejtimit, bërë nga polikarbonat në formën e një kartoni, i lëshuar që nga data 9 maj 2008



MODELET E LEJEVE TË DREJTIMIT TË LËSHUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

- I. Leja e drejtimit prej *letre*, ("modeli i vjetër"), e lëshuar deri më 30 qershor 2005, e vlefshme deri me 1 korrik 2015.



KLASË E DREJTIMIT, AB APRESIE	NR. I LEJES	SHALLI, VAKA
A	123456789	1
B	123456789	2
C	123456789	3
D	123456789	4
E	123456789	5
F	123456789	6
G	123456789	7

- II. Leja e drejtimit prej *kartoni*, ("modeli i ri"), në përdorim zyrtar që nga data 01 korrik 2005.





SHTOJCA 5

TABELAT E BARAZVLEFSHËRISË

- I. Për konvertimin e lejeve të drejtimit të lëshuara në Malin e Zi (deri më 7 janar 2013), me leje drejtimi shqiptare

Lejet e drejtimit të Malit të Zi	Leje Drejtimi Shqiptare						
Kategoria	A	B	C	D	BE	CE	DE
A	X						
B		X					
C		X	X				
D		X	X	X			
E					X	X	X

* Kategoritë E e një lejeje drejtimi të zëvendësuar me kategoritë BE, CE, DE, kur kategoritë B, C dhe D janë të disponueshme.

- II. Për konvertimin e lejeve të drejtimit të lëshuara që nga data 7 janar 2013 në Malin e Zi, me leje drejtimi shqiptare

Lejet e drejtimit të Malit të Zi	Leje Drejtimi Shqiptare						
Kategoria	A	B	BE	C	CE	D	DE
AM							
A1							
A2							
A	X						
B1							
B		X					
B+E			X				
C1		X					
C1+E		X	X				
C		X	X	X			
C+E		X	X	X	X		
D1		X	X				
D1+E		X	X				
D		X	X	X		X	
D+E		X	X	X	X	X	X
T*							

* Kategoritë ekuivalente nuk ekzistojnë në kategoritë shqiptare

**VENDIM****Nr. 76, datë 28.1.2015**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
ARSIMIT DHE SPORTIT TE MINISTRIA
E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË,
PËR DREJTORINË RAJONALE TË
SHËRBIMIT KOMBËTAR TË
PUNËSIMIT, KORÇË, TË ANEKSIT TË
GODINËS ME EMËRTIMIN “ISH-
SHTËPIA E USHTARAKËVE”, ME
VENDNDODHJE NË BULEVARDIN
“REPUBLIKA”, KORÇË, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 530,
DATË 7.8.2012, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit në Korçë, të aneksit të godinës, me sipërfaqe 219 m², me emërtimin “Ish-Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika”, Korçë, për mjedise pune, për krijimin e kushteve për zhvillimin normal të veprimtarisë së funksionimit të këtij institucioni.

FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: **Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë****Shërbimi Kombëtar i Punësimit**

Bashkia Korçë

Fusha e përdorimit të pronës: **Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë**

Nr. rend	A			B			C			
	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sipërfaqja totale e pronës m ²	Nga sip. totale, sa ndërtesë m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të thëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1			Administrative	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, Bulevardi Republika (ish-Shtëpia e Ushtarakëve) Korçë	219	219	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit	MMSR	SHKP/DRSHKP. Korçë (në përdorim)	Ambientet ndodhen në aneksin e godinës së ish "Shtëpisë së Ushtarakëve" me vendndodhje në bulevardin "Republika" në përdorim të MMSR

2. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë, u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Në vendimin nr. 530, datë 7.8.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për universitetin “Fan S. Noli”, në Korçë, të pronës nr. 549, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika”, Korçë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, aneksi i godinës, me sipërfaqe 219 m², të hiqet nga sipërfaqja totale e pronës me nr. 549, me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me adresë bulevardi “Republika”, Korçë.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**



VENDIM
Nr. 83, datë 28.1.2015

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E AGJENCISË PËR ZBATIMIN E
REFORMËS TERRITORIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 15, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale, më poshtë AZRT, si institucion publik qendror, person juridik, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, që financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

2. AZRT-ja ka si mision dhënien e ndihmës për garantimin e vazhdueshmërisë së funksioneve dhe shërbimeve publike, në nivel vendor, në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale.

3. AZRT-ja ka si qëllim mundësimin e zbatimit të reformës administrativo-territoriale, nëpërmjet bashkërendimit të të gjitha masave, proceseve dhe mbështetjes administrative deri në arritjen e funksionalitetit të plotë të 61 bashkive të reja.

4. AZRT-ja ka këto detyra dhe përgjegjësi specifike:

a) Mbështet ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore në bashkërendimin e masave dhe proceseve ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organeve të qeverisjes vendore, në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale.

b) Mbështet dhe udhëzon punën administrative të institucioneve shtetërore dhe organeve të qeverisjes vendore për zbatimin e legjislacionit në fuqi, në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale.

c) Ofron shërbime për njësitë e qeverisjes vendore, në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale.

ç) Bashkërendon punën me organizmat dhe partnerët ndërkombëtarë që mbështetin reformën administrativo-territoriale.

d) Ndërmerr dhe/ose zbaton projekte në mbështetje të njërive të qeverisjes vendore për garantimin e funksionalitetit administrativ dhe infrastrukturor, në kuadër të reformës administrativo-territoriale.

dh) Ndihmon në hartimin e ndryshimeve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për zbatimin e reformës administrative-territoriale.

e) Informon në mënyrë periodike institucionet publike dhe grupet e interesit për ecurinë e zbatimit të reformës administrativo-territoriale.

ë) Bën vlerësimin e kërkesave të njërive të qeverisjes vendore për përdorimin e fondit transitor për zbatimin e reformës territoriale, të parashikuar në pikën 8 të aneksit nr. 1, bashkëlidhur ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”. Mbi bazën e këtij vlerësimi, AZRT-ja i propozon ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore hartimin dhe iniciimin e projektvendimeve për përdorimin e këtij fondi për shqyrtim në Këshillin e Ministrave.

5. AZRT-ja ka gjithsej 12 punonjës. Organizma dhe struktura e AZRT-së përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

6. AZRT-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie.

7. Drejtori i Përgjithshëm i AZRT-së emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore.

8. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj agjencie rregullohen me Kodin e Punës. Ata emërohen, lirohen ose shkarkohen nga drejtori i Përgjithshëm, me miratimin e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore.

9. Ngarkohen Kryeministria, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM**Nr. 1, datë 27.1.2015****PËR CERTIFIKIMIN E KAFSHËVE
DHE PRODUKTEVE ME ORIGJINË
SHTAZORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të neneve 55, 56, 57 dhe 58 të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, dhe akteve nënligjore në fuqi, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Bujqësore dhe Peshkimit,

UDHËZOJ:**KREU I. TË PËRGJITHSHME**

1. Ky udhëzim përcakton rregullat që duhet të respektohen në lëshimin e certifikatave shëndetësore të kërkuara nga legjislacioni veterinar dhe ai i ushqimit, për të siguruar plotësisht integritetin e certifikimit dhe funksionimin normal të tregut të kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore.

2. Për qëllimet e këtij udhëzimi:

“Legjislacioni veterinar dhe ai i ushqimit” nënkupton legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë për shërbimin veterinar dhe për ushqimin, si dhe aktet nënligjore në fuqi në zbatim të tyre;

“Zyrtari certifikues” nënkupton veterinerin zyrtar/inspektorin zyrtar ose - në rastet e parashikuara në legjislacionin veterinar dhe atë të ushqimit - çdo person tjetër i autorizuar nga autoriteti kompetent për të nënshkruar certifikatat shëndetësore të kërkuara nga ky legjislacion.

KREU II. ZYRTARI CERTIFIKUES

1. Autoriteti kompetent duhet të sigurojë që zyrtari certifikues të ketë njohuri të kënaqshme të legjislacionit veterinar dhe ushqimor në lidhje me kafshët ose produktet që duhet të certifikohen dhe në përgjithësi, të informohen për rregullat që duhet të ndiqen për hartimin dhe lëshimin e certifikatave dhe nëse është e nevojshme, lidhur me natyrën dhe shtrirjen e kërkesave, testeve ose ekzaminimeve, të cilat duhet të kryhen para certifikimit.

2. Zyrtari certifikues nuk duhet të vërtetojë të dhëna për të cilat ai nuk ka njohuri personale ose të cilat nuk mund të konstatohen nga ana e tij.

3. Zyrtari certifikues nuk duhet të firmosë certifikata bosh ose të paplota, ose certifikata që kanë të bëjnë me kafshë ose produkte, të cilat ai nuk i ka inspektuar ose që kanë kaluar jashtë kontrollit të tij. Kur certifikata është nënshkruar në bazë të një certifikate tjetër apo një vërtetimi, zyrtari certifikues duhet ta posedojë këtë dokument përpara nënshkrimit.

4. Asgjë në këtë kre nuk duhet të pengojë një zyrtar certifikues nga vërtetimi i të dhënave, të cilat:

a) konstatohen në bazë të paragrafëve 1 deri në 3 të këtij kreu nga një person tjetër, që është i autorizuar nga autoriteti kompetent dhe që vepron nën kontrollin e zyrtarit certifikues, me kusht që ai ose ajo të mund të verifikojnë saktësinë e të dhënave; ose

b) përftohen, në kontekstin e programeve të monitorimit referuar zyrtarisht skemave të sigurimit të cilësisë ose me anë të një sistemi të mbikëqyrjes epidemiologjike, kur kjo është e autorizuar sipas legjislacionit veterinar.

KREU III. INTEGRITETI I CERTIFIKIMIT

1. Autoriteti kompetent duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar integritetin e certifikimit. Në mënyrë të veçantë duhet të sigurojë që zyrtarët që janë caktuar nga ana e tij:

a) kanë një status që siguron objektivitetin e tyre dhe nuk kanë asnjë interes të drejtpërdrejtë tregtar në kafshët ose produktet shtazore që certifikohen ose në fermat apo stabilimentet nga të cilat ato kanë origjinën;

b) janë plotësisht të vetëdijshëm për rëndësinë e përmbajtjes së secilës certifikatë të cilën ata nënshkruajnë.

2. Certifikatat nga zyrtari certifikues duhet të hartohen në gjuhën shqipe dhe të paktën në një nga gjuhët zyrtare të vendit të destinacionit të ngarkesës.

3. Autoriteti kompetent duhet të jetë në gjendje në çdo moment që të identifikojë zyrtarin përkatës që ka lëshuar një certifikatë të caktuar dhe të sigurojë që një kopje e të gjitha certifikatave të lëshuara nga ana e tij, të jetë në dispozicion për një periudhë që duhet të përcaktohet nga autoriteti kompetent.



KREU IV. KONTROLLET

1. Autoriteti kompetent duhet të zbatojë kontrolle dhe të zbatojë masa të tilla kontrolli që janë të nevojshme për të parandaluar lëshimin e certifikatave të rreme ose çorientuese dhe prodhimin fals ose përdorimin e certifikatave të supozuara që lëshohen për qëllimet e legjislacionit veterinar dhe ushqimor.

2. Pa paragjykuar ndonjë procedurë ligjore apo sanksion, autoriteti kompetent duhet të kryejë hetime ose verifikime dhe të ndërmarrë masat e duhura për të ndëshkuar çdo rast të certifikimit të rremë ose mashtrues, të cilat janë sjellë në vëmendjen e tij. Masa të tilla mund të përfshijnë pezullimin e përkohshëm të zyrtarëve certifikues nga detyrat e tyre derisa të përfundojë hetimi.

Në veçanti, nëse rezulton gjatë kontrolleve dhe vërtetohet që:

a) një zyrtar ka lëshuar një certifikatë të rreme me vetëdije, autoriteti kompetent do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar, për aq sa është e mundur, që personi në fjalë nuk mund të përsërisë shkeljen;

b) një individ ose një ndërmarrje ka bërë përdorim mashtrues ose ka ndryshuar një certifikatë zyrtare, autoriteti kompetent do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar, për aq sa është e mundur, që individ apo ndërmarrja në fjalë nuk mund të përsërisin shkeljen. Këto masa mund të përfshijnë edhe refuzimin më pas për t'i lëshuar një certifikatë zyrtare personit ose ndërmarrjes në fjalë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT
TË UJËRAVE
Edmond Panariti

UDHËZIM

Nr. 10, datë 26.1.2015

**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT
E SHQYRTIMIT TË ANKIMEVE
ADMINISTRATIVE TË SUBJEKTEVE
MINERARE TË LICENCUARA**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, si dhe të pikës 5 të nenit 45, pikës 5 të nenit 46, të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar

Faqe | 550

UDHËZOJ:

1. Subjekti ndaj të cilit vendoset masa administrative apo masa e pezullimit të lejes, ka të drejtën e ankimit pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit.

2. Subjekti ankimues duhet që, në momentin e dorëzimit të ankimit, të vërtetojë datën e marrjes së aktit administrativ, objekt ankimi. Si provë mund të shërbejë kopja e zarfit nëpërmjet të cilit është dërguar akti administrativ pranë subjektit ankimues, kopja e regjistrimit të dorëzimit të objekteve postare nga zyra postare, apo çdo dokument tjetër që vërteton datën e marrjes së këtij akti.

3. Ankimi bëhet në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe mund të dorëzohet dorazi në protokoll ose dërgohet me postë rekomande. Data e marrjes së ankimit nga njësia e vlerësimit të ankimeve të masave administrative konsiderohet data e protokollimit në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për ankimet e dorëzuara në protokoll. Për rastet e ankimeve të dërguara me postë rekomande, data e dorëzimit të ankimit nga subjekti konsiderohet data e dorëzimit në postë.

4. Ankimi me shkrim dhe dokumentacioni që i bashkëngjitet duhet të përfshijë:

- a) Emrin dhe adresën e subjektit ankimues;
- b) Numrin e regjistrimit të subjektit (NIPT);
- c) Numrin e lejes minerare për të cilën është marrë masa administrative;
- ç) Aktin administrativ, që është objekt ankimi;
- d) Informacion në mbështetje të ankimit (aktin e kontrollit, procesverbalet, etj.).

dh) Argumentimin për arsyet e ankimit të masës administrative;

e) Çdo dokument tjetër provues që ankimuesi kërkon të merret në shqyrtim;

ë) Nënshkrimin e tij.

5. Shqyrtimi i ankimeve administrative bëhet nga njësia e vlerësimit të ankimeve të masave administrative, të ngritur me urdher ministri.

6. Njësia e vlerësimit të ankimeve përbëhet nga 7 anëtarë, me përbërje si më poshtë:

Sekretari i Përgjithshëm, kryetar

Dy përfaqësues nga Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit Minerar,

Një përfaqësues nga Drejtoria Juridike,

Një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore,



Një përfaqësues nga Reparti i Inspektim – Shpëtim-Minierave

Një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.

7. Anëtarët e njësisë së vlerësimit të ankimeve nuk duhet të kenë marrë pjesë në procedurat e dhënies së masave administrative apo pezullimit të lejeve.

8. Njësia e vlerësimit të ankimeve të masave administrative mbledhet me kërkesë të kryetarit, sa herë që kërkohet shqyrtimi i ankimeve të masave administrative të subjekteve minerare.

9. Mbledhja zhvillohet vetëm nëse janë prezent shumica e anëtarëve të njësisë.

10. Njësia përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, që mbulon veprimtarinë minerare, përgatit informacionin dhe materialet e duhura për zhvillimin e mbledhjes së njësisë së ankimit.

11. Njësia e vlerësimit të ankimeve të masave administrative fillimisht verifikon paraprakisht kushtet formale të ankesës lidhur me:

a) juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të njësisë së vlerësimit të ankimeve të masave administrative;

b) legjitimitimin e ankuesit;

c) respektimin e afateve ligjore për ankimim;

d) elementet e domosdoshme të ankesës.

12. Pas vlerësimit të kushteve formale të ankesës, njësia e vlerësimit të ankimeve të masave administrative shqyrton ankimin, vlerëson provat dhe me shumicë të thjeshtë merr një nga vendimet e mëposhtme:

a) mospranimin e ankesës për shkak të mungesës së kushteve formale të saj, të përcaktuara në pikën 4 të këtij udhëzimi.

b) pranimin e ankimit të subjektit, duke argumentuar shkeljen e konstatuar në zbatimin e ligjit në marrjen e masës administrative ndaj subjektit ankimues.

c) pranimin e pjesshëm të ankimit, duke argumentuar sipas rastit shkeljen e konstatuar në zbatimin e ligjit në marrjen e kundërvajtjes administrative.

ç) lënien në fuqi të aktit administrativ, duke argumentuar zbatimin e drejtë të procedurave dhe ligjshmërisë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankuesi ka pretenduar shkelje.

13. Gjatë mbledhjeve mbahet procesverbal, i cili përmban arsyet e votimit por ose kundër, si dhe rezultatin përfundimtar të votimit. Procesverbali

nënshkruhet nga personi që e mban atë dhe nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje.

14. Njësia e vlerësimit të ankimeve të masave administrative, kur gjykon se provat janë të pamjaftueshme për të marrë një vendim, mund të kërkojë prova shtesë nga subjekti ankimues, apo nga struktura përgjegjëse e cila ka vendosur masën administrative.

15. Njësia e vlerësimit të ankimeve të masave administrative administron dhe shqyrton provat e njofton vendimin brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankimit. Ky afat mund të shtyhet nga ministria deri në 10 ditë kalendarike, në rast se çmohet kryerja e verifikimeve në vendin ku ushtrohet veprimtaria minerare dhe me kusht që të njoftohet subjekti, ndaj të cilit është vendosur masa administrative.

16. Kundër vendimit të strukturës përgjegjëse dhe vendimit të njësisë së ankimit, subjekti mund të bëjë ankim në gjykatën administrative sipas legjislacionit në fuqi.

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen njësia e vlerësimit të ankimeve të masave administrative dhe Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit Minerar.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Damian Gjiknuri

UDHËZIM

Nr. 17, datë 28.1.2015

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR MIRATIMIN E NËNKONTRAKTIMIT TË SË DREJTËS SË LEJES MINERARE, PËR KËRKIM -ZBULIM, PËR SHFRYTËZIM APO PËR KËRKIM-ZBULIM- SHFRYTËZIM

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 17/1 "Nënkontraktimi" të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Shoqëria zotëruese e lejes minerare, e cila kërkon nënkontraktimin e të drejtës së shfrytëzimit të lejes minerare, për kërkim-zbulim, për shfrytëzim apo për kërkim-zbulim-shfrytëzim, duhet të paraqesë zyrtarisht pranë Ministrisë së Energjisë



dhe Industrisë kërkesën për miratimin paraprak të nënkontraktorit të përzgjedhur prej saj. Kërkesa e shoqërisë zotëruese të lejes minerare duhet të argumentojë arsyet e nënkontraktimit.

2. Kërkesa e shoqërisë duhet të shoqërohet me:

2.1 Marrëveshjen për nënkontraktimin e të drejtës minerare.

2.2 Vendimin e asamblesë së shoqërisë zotëruese të lejes minerare për nënkontraktimin e të drejtës minerare.

2.3 Dokumentacionin për shoqërinë nënkontraktore:

- Ekstrakt historik i shoqërisë, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

- Vërtetim se shoqëria nuk është në proces falimentimi;

- Vërtetim se shoqëria nuk është dënuar për shkelje penale;

- Vërtetim se shoqëria nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;

- Vërtetim se shoqëria ka plotësuar detyrimet fiskale;

- Vërtetim se shoqëria ka plotësuar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore;

- Vërtetim se shoqëria ka plotësuar detyrimet për energjinë elektrike, të lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;

- Vërtetime mbi përvojën në fushën minerare apo referenca për përbushje të suksesshme të punimeve minerare të ngjashme, të lëshuara nga një institucion publik, ose privat që tregon vlerën, kohën dhe natyrën e punimeve të kryera, dhe/ose çdo dokument tjetër që parashikon legjislacionin në fuqi dhe që mund ta vërtetojë një gjë të tillë.

- Historik të aktivitetit të shoqërisë;

- Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve që lidhen me kryerjen e punimeve të planit të investimit;

- Licenca profesionale e drejtuesit teknik dhe kontratën me drejtuesin teknik;

- Dëshmi mbi fuqinë mesatare punëtore të nënkontraktorit dhe stafit drejtues;

- Lista e mjeteve e shoqëruar me dokumentet që vërtetojnë të drejtat reale që subjekti gëzon ndaj mjetit (pronësi, qira, përdorim etj.).

2.4 Në rastet kur shoqëria nënkontraktore merr përsipër të kryejë edhe investimin në objektin minerar, duhet të paraqesë gjithashtu:

- Kopje të pasqyrave financiare të dy viteve të fundit, të certifikuar nga administrata tatimore;

- Vërtetim të xhiros vjetore të dy viteve të fundit, të lëshuara nga autoritetet përkatëse, ku shoqëria ka selinë zyrtare;

- Vërtetim nga banka, që konfirmon se personi juridik ka të depozituara në numrin e llogarisë të paktën 20% të vlerës së investimit të parashikuar për t'u realizuar në objektin për të cilin është bërë marrëveshja e nënkontraktimit. Vërtetimi duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të dokumentacionit në MEI.

Dokumentet e paraqitura duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara dhe të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e dorëzimit të dokumentacionit në MEI.

3. Kërkesa e shoqërisë zotëruese të lejes minerare shqyrtohet dhe vlerësohet nga Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit Minerar.

4. Kërkesa për nënkontraktim nuk miratohet:

a) Në rastet kur shoqëria zotëruese e lejes minerare nuk ka plotësuar detyrimet ligjore që lidhen me lejen minerare për të cilën kërkohet nënkontraktimi.

b) Në rastet kur shoqëria nënkontraktuese:

- Ka të revokuar ndonjë leje minerare në dy vitet e fundit nga autoriteti kontraktues;

- Ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

- Është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

- Është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

- Nuk i ka përbushur detyrimet fiskale, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozita të zbatueshme në shtetin e origjinës;

- Nuk i ka përbushur detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar;

- Nuk ka paguar detyrimet për energjinë elektrike për Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë;



- Nuk vërteton përvojën e tij në fushën minerare, me dokumentacionin e përcaktuar në këtë udhëzim;

- Nuk paraqet kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve që lidhen me ekzekutimin e punimeve të planit të investimit;

- Nuk paraqet licencën profesionale dhe kontratën me drejtuesin teknik;

- Drejtuesi teknik nuk plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 16.6.2011.

- Nuk paraqet dëshmi mbi fuqinë mesatare punëtore të shoqërisë dhe stafit drejtues;

- Nuk paraqet listën e mjeteve, të shoqëruar me dokumente që vërteton të drejtat reale që nënkontraktori gëzon ndaj mjetit (pronësi, qira, përdorim etj.);

- Ka marrë përsipër të kryejë investimin në objektin e nënkontraktuar dhe nuk vërteton se ka të depozituara në një bankë të paktën 20% të vlerës së investimit të parashikuar për t'u realizuar në objektin e marrë për nënkontraktim.

5. Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit Minerar përgatit informacionin e nevojshëm mbi procedurën e ndjekur për trajtimin e kërkesës dhe e përcjellin praktikën te ministri/sekretari i përgjithshëm për miratim ose refuzim.

6. Referuar nenit 17/1, pika 3 të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar", të ndryshuar, zotëruesi i lejes minerare është përgjegjës përpara strukturave përgjegjëse për zbatimin e kushteve e të kërkesave të lejes minerare, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të tjera, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Zotëruesi i lejes minerare dhe nënkontraktori janë përgjegjës përpara strukturave përgjegjëse për zbatimin e kushteve dhe rregullave të sigurimit teknik në zonën, në të cilën ushtrohet aktiviteti minerar i nënkontraktuar. Përgjegjësitë për zbatimin dhe respektimin e rregullave të sigurimit teknik përcaktohen në marrëveshjen e nënshkruar midis palëve.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit Minerar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Damian Gjiknuri

URDHËR

Nr. 9, datë 29.1.2015

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të neneve 27 dhe 29, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave është autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit, në lidhje me proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Financave, në proceset gjyqësore, kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen për aparatin e Ministrisë së Financave, nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit, që do të përfaqësojë ministrinë.

3. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Financave, në proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, kur thirret si subjekt i interesuar, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

4. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Financave në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, gjatë seancës përkatëse të gjykimit, me përjashtim të nënshkrimit të akteve procedurale të tilla si, por pa u kufizuar: kërkesë-padi, ankime, rekurse, kërkesa për pezullim ekzekutim vendimi.

5. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm deri në miratimin e këtij urdhri, të cilat janë përdoruar ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit të ministrit të Financave nr. 35, datë 17.3.2009, shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor përkatës.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe struktura përgjegjëse për çështjet juridike në Ministrinë e Financave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Shkëlqim Cani



VENDIM
Nr. 4, datë 2.2.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"

me sekretare Blerina Basha, në datën 4.6.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare me dyer të hapura, çështjen nr. 17/1, 18/2 Akti që i përket:

KËRKUESE: Bashkia e Tiranës, Bashkia e Krujës dhe Komuna Katund i Ri Durrës, përfaqësuar nga z. Ivi Kaso, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli Kombëtar i Territorit, përfaqësuar nga znj. Jonida Gaba, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga znj. Majlinda Dhuka dhe z. Artur Metani, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet qeverisjes vendore: Bashkia e Tiranës, bashkia e Krujës, komuna Katund i Ri, dhe pushtetit qendror: Këshilli i Ministrave/Këshilli Kombëtar i Territorit.

2. Shqyrtimi i pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe me Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore, si dhe shfuqizimi si antikushtetues, si akte që bëhen shkak për lindje të konfliktit, i vendimeve nr. 1, datë 8.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në disa zona me rëndësi kombëtare dhe procedurën e hartimit të Planit të Integruar Sektorial për Brezin Bregdetar”, dhe nr. 3, datë 18.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në zonën me rëndësi të veçantë të Kurorës së Tiranës”.

3. Pezullimin e vendimeve nr. 1, datë 8.10.2013 dhe nr. 3, datë 18.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 124/1, 131/ç, dhe 134/1/c të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenet 54, 55 dhe 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha; pretendimet e kërkuësve, Bashkia e Tiranës, Bashkia e Krujës dhe komuna Katund i Ri Durrës, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës; prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Këshilli Kombëtar i Territorit, të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 1, datë 08.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në disa zona me rëndësi kombëtare dhe procedurën e hartimit të Planit të Integruar Sektorial për Brezin Bregdetar” (vendimi nr. 1/2013), është bërë përcaktimi i zonave ku do të ndërhyhet me masa të natyrës emergjente, me qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin mjedisor të: brezit bregdetar, detit territorial dhe ishujve, bashkive Krujë, Berat e Gjirokastrë, rrugëve kombëtare kryesore dhe brezave të rezervuar të tyre, si edhe të hekurudhës Tiranë – Durrës dhe zonës së saj mbrojtëse.

2. Me vendimin nr. 3, datë 18.10.2013 të KKT-së “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në zonën me rëndësi të veçantë të Kurorës së Tiranës” (vendimi nr. 3/2013), është bërë përcaktimi i zonave ku do të ndërhyhet me masa të natyrës emergjente, me qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin mjedisor të Kurorës së Tiranës.

3. Me vendimet e mësipërme është vendosur, gjithashtu, “pezuillimi i dhënies së të gjitha llojeve të lejeve zhvillimore në këto zona, nga autoritetet e planifikimit, deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.” Po sipas vendimeve, përjashtim nga pezullimi bëjnë punimet e mirëmbajtjes dhe lejet zhvillimore për interes publik, shtetëror dhe kombëtar.



II

4. *Kërkuesit, Bashkia e Tiranës, bashkia e Krujës dhe komuna “Katundi i Ri” Durrës*, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), me dy kërkesa të ndryshme, me objekt: zgjidhjen e konfliktit të kompetencave të lindur mes tyre, si organe të qeverisjes vendore, dhe KKT-së, si organ i pushtetit qendror, si pasojë e miratimit të vendimeve nr. 1/2013 dhe nr. 3/2013, si dhe shfuqizimin e këtyre vendimeve, si akte që janë bërë shkas për lindjen e këtij konflikti. Pretendimet e kërkuesve janë bazuar në të njëjtat shkaqe, që në mënyrë të përmblodhur janë si vijon:

4.1 Mosmarrëveshja e kompetencës, e lindur ndërmjet organeve të qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror, ka sjellë si pasojë bllokimin e veprimtarisë shtetërore në fushën urbane për njësitë e qeverisjes vendore, çka është e papajtueshme me parimet kushtetuese dhe ato të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

4.2 Duke i atribuar pushtetit qendror çështje të administrimit të ndërtimeve dhe të territorit, si dhe duke u bllokuar vendimmarrja dhe veprimtaria e organeve të qeverisjes vendore në fushën e planifikimit, të menaxhimit urban dhe të kontrollit të territorit, është cenuar parimi i decentralizimit të pushtetit vendor, i autonomisë vendore dhe i proporcionalitetit të ndërhyrjes së pushtetit qendror.

4.3 Organet e qeverisjes vendore, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (ligji nr. 8652/2000), ushtrojnë si funksione të vetat planifikimin urban dhe menaxhimin e tokës dhe, në përputhje me kompetencat e tyre, ato kanë hartuar planet e përgjithshme ose planet e detajuara vendore. Pezullimi i dhënies të lejeve të ndërtimit, i vendosur nga KKT-ja me vendimet e kundërshtuara, e bën të paretizueshëm dhe joefektiv planin rregullues të hartuar prej organeve të qeverisjes vendore, duke cenuar drejtpërdrejt veprimtarinë e tyre.

4.4 Pezullimi i zhvillimit, megjithëse parashikohet nga ligji nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” (ligji nr. 10119/2009), përcakton se ai (pezullimi) duhet të jetë proporcional me qëllimin që kërkon të arrijë organi i pushtetit qendror. Në rastin konkret, KKT-ja nuk

i ka marrë parasysh kriteret ligjore për vendosjen e masës së pezullimit.

4.5 KKT-ja ka vendosur *apriori* dhe në mënyrë abuzive pezullimin e dhënies së lejeve të reja zhvillimore të ndërtimit për objekte individuale dhe grup-objekte individuale, si dhe pezullimin e planeve të detajuara vendore, nga të gjitha autoritetet e qeverisjes vendore të planifikimit.

4.6 Konsiderohet si cenim i së drejtës për vetëqeverisje të pushtetit vendor, nëse pushteti qendror, duke u hequr kompetenca organeve vendore, do ta dobësonte aq shumë rolin e këtyre, sa që ekzistenca ose vetëqeverisja e tyre do të bëheshin të pandjeshme.

5. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Këshilli Kombëtar i Territorit kanë prapësuar para Gjykatës sa vijon:

5.1 Vendimi nr. 3/2013 i KKT-së nuk i shtrin efektet e tij në territorin administrativ të Bashkisë së Tiranës, ndërsa vendimi nr. 1/2013 nuk ndërhyr në kompetencat e Bashkisë së Tiranës, bashkisë së Krujës dhe komunës Katund i Ri Durrës. Për rrjedhojë, kërkuesit nuk janë subjekte të cenuara prej vendimmarrjes së KKT-së, objekt i këtij shqyrtimi.

5.2 Nga të tria kushtet që kërkon jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese për të pasur (dhe për të zgjidhur më pas) një mosmarrëveshje kompetencash, në rastin në shqyrtim plotësohen vetëm dy kushtet e para. Ndërkohë, rezulton se nuk plotësohet kushti i tretë (që lidhet me kompetencën kushtetuese), pasi kompetenca e KKT-së nuk është kompetencë kushtetuese, sepse në asnjë normë të Kushtetutës nuk parashikohen, as shprehimisht, por as në mënyrë të nënkuptuar, kompetencat e këtij organi të pushtetit qendror. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të shqyrtuar çështje që sipas legjislacionit i përkasin juridiksionit të zakonshëm gjyqësor.

5.3 Thelbi i mosmarrëveshjes nuk janë aktet e kundërshtuara, por interpretimi jokushtetues që kërkuesit i kanë bërë ligjit nr. 10119/2009 në tërësinë e tij, e në veçanti dispozitave të neneve 1, 2, 3, 6, 8, 18/2, 26, 32, 63, 64 e 70 të këtij ligji. Janë pikërisht këto dispozita që i japin subjektit të interesuar kompetencën për të miratuar aktet e kundërshtuara.

5.4 Pezullimi i përkohshëm i zhvillimit, si një instrument tipik dhe urgjent në dispozicion të autoritetit të planifikimit për kontrollin e



zhvillimit të territorit, është vlerësuar të jetë i vetmi instrument që në kushtet aktuale garanton realizimin e interesit të gjerë publik të ruajtjes, në gjendjen aktuale, të Kurorës së Tiranës dhe zonave që përfshihen në bashkinë Krujë dhe komunën Katund i Ri Durrës, deri në miratimin e planit të përgjithshëm kombëtar.

5.5 KKT-ja, në zbatim të ligjit për planifikimin e territorit, ka marrë vendimet nr. 1/2013 dhe nr. 3/2013, duke pezulluar zhvillimin në zona të veçanta të rëndësisë kombëtare, sikurse edhe zona e Kurorës së Tiranës (dhe në mënyrë të ngjashme, zonat e bregdetit, qendrat historike etj.) deri në hartimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, por pa marrë për vete asnjë nga kompetencat (planifikuese, menaxhuese apo ndërtimore) që u takojnë me ligj njësisë të qeverisjes vendore.

5.6 Edhe Karta Evropiane e Autonomisë Vendore që thekson parimin e subsidiaritetit, lejon dhënien e një përgjegjësie një autoriteti tjetër, me kusht që të mbahen parasysh disa kritere.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

6. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, përpara fillimit të shqyrtimit të çështjes, për shkak se kërkesat kanë të njëjtin objekt dhe janë bazuar në të njëjtat shkaqe, vendosi bashkimin e tyre dhe shqyrtimin në një çështje të vetme.

A. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimeve nr. 1/2013 dhe nr. 3/2013 të KKT-së

7. Kërkesit kanë kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të vendimeve nr. 1/2013 dhe nr. 3/2013 të KKT-së deri në dhënien e vendimit përfundimtar të Gjykatës, me pretendimin se pezullimi i dhënies së lejeve të zhvillimit dhe i planeve vendore cenon si interesat e bashkive e komunave, ashtu edhe të individëve.

8. Gjykata vëren se kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për të pezulluar një akt normativ, zbatimi i të cilit mund të sjellë pasoja të rënda deri në dhënien e vendimit përfundimtar të Gjykatës për çështjen në shqyrtim, është parashikuar nga neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 8577/2000). Sipas kësaj

dispozite, Gjykata Kushtetuese, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të pezullojë zbatimin e normës që shqyrtohet deri në dhënien e vendimit nga kjo Gjykatë. Subjekti që kërkon pezullimin e një akti duhet të provojë preken e interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si dhe pasojat e pariparueshme që do të sillte zbatimi i aktit të kundërshtuar.

9. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimeve nr. 1/2013 dhe nr. 3/2013 të KKT-së, objekt shqyrtimi. Për arsye se Mbledhja e Gjyqtarëve nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e cenimit të interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtyre vendimeve, me vendimin e datës 09.04.2014 vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim.

B Për legjitimitimin e kërkesësve

10. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në prapësimet e tij ka pretenduar se kërkuesi, Bashkia e Tiranës, nuk legjitimohet për inicimin e këtij gjykimi kushtetues, për arsye se ajo nuk është as subjekt në konflikt dhe as subjekt i prekur drejtpërdrejt nga konflikti.

11. Bazuar në nenin 131, shkronja “ç”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), si dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror - qeverisje vendore). Kjo dispozitë kushtetuese është detajuar në nenin 54 të ligjit nr. 8577/2000, i cili parashikon se kërkesa ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti (pika 3) dhe se bazë për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve përbën çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve ose i organeve të qeverisjes vendore që ka çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre (pika 4). Pavarësisht nga karakteri i shkakut që lind mosmarrëveshjen, Gjykata vendos, sipas nenit 56 të po këtij ligji, se cili organ i pushtetit ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Veç kësaj, kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ka të bëjë me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata shqyrton gjithashtu edhe



kushtetueshmërinë apo ligjshmërinë e aktit (*shih vendimin nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata vëren se kërkuesit, Bashkia e Tiranës, bashkia e Krujës dhe komuna Katund i Ri Durrës, të cilat, në kuptim të ligjit nr. 8652/2000, janë njësi bazë të qeverisjes vendore, i janë drejtuar kësaj Gjykate duke pretenduar se me anë të akteve të kundërshtuara të miratuara nga KKT-ja është ndërhyrë në sferën e veprimtarisë së tyre, pra në ushtrimin e kompetencave të këtyre organeve për planifikimin dhe menaxhimin e territorit. Ato pretendojnë se pezullimi i së drejtës të ushtrimit të funksioneve të tyre nga ana e këtij organi të pushtetit vendor (KKT-ja) pa asnjë afat dhe pa asnjë kriter, përbën cenim të kompetencave të tyre, në kundërshtim me parimin e decentralizimit të pushtetit, të autonomisë vendore, të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit, të parashikuara në nenin 13 të Kushtetutës dhe në Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, formalisht, janë të pranishme elementet e një mosmarrëveshjeje kompetencash. Kërkesa është ngritur nga organe të qeverisjes vendore, të cilat pretendojnë se një organ i qeverisjes qendrore e ka konsideruar veten kompetent për pezullimin e lejeve të zhvillimit të territorit, çka, sipas tyre, bën pjesë në funksionet e veta të tyre, të njohura nga Kushtetuta, dhe kanë kërkuar edhe shfuqizimin e akteve që janë bërë shkak për lindjen e kësaj mosmarrëveshjeje.

13. Për sa i përket legjitimitimit formal dhe procedural, është pikërisht kryetari i komunës/bashkisë, si organ i qeverisjes vendore, që justifikon interesin e tij për të vënë në lëvizje Gjykatën në këtë rast. Bazuar në ligjin nr. 8652/2000, kryetari i komunës/bashkisë ushtron të gjitha kompetencat që ligji u ka njohur njësisë bazë të qeverisjes vendore në fushën e planifikimit urban, kurse bazuar në nenin 70/10 të ligjit nr. 10119/2009, kryetari i komunës/bashkisë është autoriteti përgjegjës për pranimin, shqyrtimin dhe vendimmarrjen për kërkesa për leje zhvillimore, leje objekti, leje infrastrukture apo leje të veçantë, brenda territorit në juridiksion të bashkisë. Për sa më sipër, kërkuesit legjitimohen edhe *ratione personae* në paraqitjen e kësaj kërkesë.

14. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, sepse kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor 6-mujor nga lindja e shkakut të

konfliktit, në përputhje me nenin 50 të ligjit nr. 8577/2000.

C Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

15. **Subjekti i interesuar**, Këshilli i Ministrave, ka ngritur edhe pretendimin për mungesën e juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e vendimeve të KKT-së, për shkak të karakterit individual dhe jo normativ të këtyre akteve. Sipas këtij subjekti, vendimet nr. 1/2013 dhe nr. 3/2013 janë akte me karakter individual dhe, si të tilla, nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues, sipas nenit 131/c të Kushtetutës. Në këto kushte, sipas subjektit të interesuar, kërkuesit nuk legjitimohen *ratione materiae*.

16. Gjykata vëren se në shkronjën “c” të nenit 131 të Kushtetutës është parashikuar kompetenca e saj për të vendosur për pajtueshmërinë me Kushtetutën të akteve normative të organeve qendrore dhe vendore. Në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese, vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetueshmërisë së normës, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Prandaj, gjatë ushtrimit të kontrollit abstrakt të normës, Gjykata ndalet, paraprakisht, në vlerësimin e natyrës së aktit të kundërshtuar, çka lidhet drejtpërdrejt me juridiksionin e saj mbi shqyrtimin substancial të aktit normativ.

17. Ndërsa kompetenca e Gjykatës për të vendosur për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, është parashikuar në shkronjën “ç” të nenit 131 të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet në formën e konfliktit “*normativ*”, kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu si edhe në formën e konfliktit “*individual*”, kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse për zbatimin e një ligji konkret, akt i cili bëhet shkak për mosmarrëveshje. Mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen edhe kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, kur e njëjta kompetencë u atribuohet sipas ligjeve të ndryshme dy institucioneve, si dhe kur ligji parashikon kompetencën, por pa saktësuar organin që duhet ta ushtrojë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk



mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto*. Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe ka nxjerrë, mbi këtë bazë, aktin individual të zbatimit (*shih vendimet nr. 26, datë 04.12.2006; nr. 29, datë 21.12.2006 dhe nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Neni 54/4 i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se “*çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve ose i organeve të qeverisjes vendore, që kanë çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre, përbëjnë bazat për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve*.” Në praktikë, një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit, me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit. Në këtë mënyrë, vlerësimi i Gjykatës përqendrohet mbi mosmarrëveshjen në lidhje me kryerjen e funksioneve të nivelit kushtetues, për të cilin akti është thjesht (edhe pse i nevojshëm) një tregues. Gjykata zgjidh konfliktin që i nënshtrohet gjykimit të saj, duke deklaruar pushtetin të cilit i takojnë kompetencat në diskutim, çka është edhe qëllimi i këtij lloj kontrolli dhe kur është nxjerrë një akt i vesuar nga moskompetenca, e shfuqizon atë. Në çështje të tilla, ushtrimi i kësaj kompetence të Gjykatës nuk kufizohet nga natyra e aktit që është bërë shkak për lindjen e konfliktit, prandaj ai mund të jetë një akt çfarëdo me karakter ligjor e nënligjor ose edhe një akt formalisht dhe materialisht administrativ (*shih vendimin nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata vëren se vendimet objekt kërkesë janë akte të një organi të qeverisjes qendrore, i cili ka për funksion miratimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit të territorit, sipas ligjit. Ai është një organ që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryetar i KKT-së është Kryeministri (neni 8 i ligjit nr. 10119/2009). Për pasojë, në kushtet kur aktet objekt kërkesë janë akte të qeverisjes qendrore, ato i plotësojnë kushtet për t'u marrë në shqyrtim nga Gjykata.

20. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, për mungesën e juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e kësaj çështjeje është haptazi i pabazuar.

D. Për themelin e çështjes

21. Kërkuesit pretendojnë se aktet objekt shqyrtimi cenojnë parimin e decentralizimit të pushtetit vendor, duke i atribuuar pushtetit qendror çështje të administrimit të ndërtimeve dhe territorit, të autonomisë vendore dhe të proporcionalitetit të ndërhyrjes së pushtetit qendror, në kundërshtim edhe me standardet e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Kërkuesit pretendojnë, gjithashtu, se aktet në fjalë e bëjnë të parealizueshëm dhe joefektiv planin rregullues të hartuar prej tyre, duke u cenuar drejtpërdrejt veprimtaria e organeve të qeverisjes vendore dhe shërbimi ndaj qytetarëve, si pasojë e mosrealizimit në kohë të funksioneve të veta të këtyre organeve.

22. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe KKT-ja, i kanë prapësuar këto pretendime me argumentin se qëllimi i Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore është që shtetet palë të krijojnë kuadrin e nevojshëm që autoritetet vendore të kenë një diapazon të gjerë përgjegjësish, të mundshme për t'u realizuar në nivel vendor. Sipas tyre, kjo vendimarrje nuk është uzurpim kompetencash, por mbrojtje e interesit publik, sepse ka lidhje me emergjencën e ruajtjes dhe rehabilitimit të zonave me rëndësi të veçantë. Kjo ndërhyrje, gjithashtu, është proporcionale në raport me qëllimin që ka dashur të realizojë.

23. Gjykata, në vendimet e saj, ka theksuar se thelbi i nenit 13 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë janë parimet e decentralizimit të pushtetit dhe autonomisë vendore. Qeverisja vendore nënkupton të drejtën e njerëzve në bashkësinë e caktuar territoriale që në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre nëpërmjet organeve të cilat i zgjedhin vetë ose në mënyrë të drejtpërdrejtë. Parimi i decentralizimit të pushtetit është parim thelbësor, mbi të cilin ngrihet dhe funksionon qeverisja vendore. Ai ushtrohet nëpërmjet parimit kushtetues të autonomisë vendore dhe kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetëqeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të qeverisjes vendore, si dhe raporti që ajo ka me pushtetin qendror varen nga kuptimi kushtetues dhe ligjor që u jepet decentralizimit të pushtetit, autonomisë vendore dhe vetëqeverisjes (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).



24. Decentralizmi është një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohen nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore. Në themel të decentralizmit qëndron parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit *“ushtrimi i përgjegjësisë publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t’u takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve”*. Në realitet, shumë çështje kanë implikime si vendor, ashtu edhe kombëtare dhe përgjegjësia për to ndryshon në hapësirë dhe në kohë dhe, për më tepër, kjo përgjegjësi mund të ndahet edhe ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Gjithsesi, kufizimi i veprimtarisë së autoriteteve vendore vetëm në çështje që nuk kanë implikime të gjera, mbart rrezikun për t’i shndërruar ato në autoritete me një rol të parëndësishëm. Nga ana tjetër, është e nevojshme që pushtetit qendror t’i rezervohen disa funksione të rëndësishme me rëndësi kombëtare e strategjike. Përcaktimi i interesit të komunitetit lidhet edhe me nevojën e ekzistencës së kufijve për vetë pushtetin vendor, i cili nuk duhet të tejkalojë kompetencat e tij duke vendosur për çështje që i përkasin një vendimmarrje të pastër politike ose për çështje që kanë pasoja ekonomike për të gjithë vendin dhe jo vetëm për komunitetin vendor përkatës (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Karta Evropiane e Autonomisë Vendore, e ratifikuar me ligjin nr. 8548, datë 11.11.1999, në nenin 4, pika 3, të saj, rithekson parimin e subsidiaritetit sipas të cilit: *“Ushtrimi i përgjegjësisë publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t’u takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve. Dhënia e një përgjegjësie një autoriteti tjetër duhet të bëhet duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e aftësisë dhe të ekonomisë”*. Dispozita e sipërcituar e Kartës lejon dhënien e një përgjegjësie një autoriteti tjetër, me kusht që të mbahen parasysh disa kriterë, si rëndësia, natyra e detyrës, si dhe kërkesat e aftësisë e të ekonomisë. Gjykata ka theksuar se qëllimi i Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore është që shtetet palë të krijojnë kuadrin e nevojshëm që autoritetet vendore të kenë një diapazon të gjerë përgjegjësisë, të mundshme për t’u realizuar në nivel vendor. Kur fushat e veprimtarisë kanë implikime në nivel vendor, është e rëndësishme që në konceptimin e autoriteteve vendore që veprojnë për të zhvilluar mirëqenien e përgjithshme të banorëve të tyre, ato të kenë të

drejtën për të ushtruar iniciativën në këto çështje. Prandaj, sipas paragrafit 3, të nenit 4 të kësaj Karte, ushtrimi i përgjegjësisë duhet të shkojë drejt decentralizmit. Ky parim kërkon që, përveç rasteve kur natyra dhe përmasa e problemit është e tillë që i takon një zone shumë të madhe territoriale dhe me interesa të rëndësishme ekonomike, zgjidhja i duhet besuar qeverisë vendore (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata vëren se standardet e përgjithshme të evidentuara më sipër janë reflektuar në ligjin nr. 10119/2009, i cili përbën edhe bazën ligjore për miratimin e akteve të kundërshtuara. Duke u ndalur, në mënyrë të përmbledhur, në përcaktimet dhe dispozitat e veçanta të këtij ligji, Gjykata vëren se ai ka për objekt përcaktimin e parimeve bazë, përgjegjësisë, rregullave dhe procedurave për planifikimin e territorit (neni 2). Sipas tij, planifikimi i territorit është një veprimtari ndërdisiplinore për planifikimin e përdorimit të tokës, përcaktimin e kushteve për zhvillimin e territorit dhe të strukturave natyrore e të ndërtueshme në të, kurse instrumente të planifikimit janë: politikat, planet dhe rregulloret, që zbatohen në mënyrë të përgjithshme ndaj një territori, pjese të tij apo ndaj një tipi zhvillimi (neni 3, pikat 1 dhe 2). Po në bazë të këtij ligji, nivelet e instrumenteve të planifikimit përfshijnë atë kombëtar dhe atë vendor. Instrumentet kombëtare të planifikimit përcaktojnë ose orientojnë zhvillimin e ardhshëm në të gjithë territorin kombëtar ose në një pjesë të tij, kushtet e zhvillimit të strukturave të përfshira në to dhe vendndodhjen e përbërësve kryesorë të infrastrukturës publike kombëtare (neni 26). Kurse instrumentet vendore të planifikimit përcaktojnë zhvillimin e ardhshëm në të gjithë ose në një pjesë të territorit vendor, kushtet e zhvillimit të strukturave të përfshira në to dhe vendndodhjen e përbërësve kryesorë të infrastrukturës publike për trajtimin e çështjeve të rëndësishme vendore e kombëtare të deleguara (neni 27). Plani i Përgjithshëm Kombëtar zbatohet në të gjithë territorin kombëtar dhe hartimi e miratimi i tij mbështeten në planet kombëtare, ndërsektoriale dhe sektoriale, në rastet kur këto janë miratuar më parë, kurse instrumentet vendore të planifikimit të territorit hartohen dhe miratohen, në përputhje me



instrumentet kombëtare të planifikimit të territorit, si dhe me instrumentet e planifikimit të njësisë kufizuese të qeverisjes vendore, për çështje të rëndësishë së përbashkët.

27. Ligji i ka ndarë autoritetet e planifikimit të territorit në autoritete kombëtare dhe vendore, duke parashikuar edhe kompetencat e tyre. Sipas nenit 5 të ligjit, autoritetet kombëtare të planifikimit të territorit janë Këshilli i Ministrave, KKT-ja, AKPT-ja, si dhe çdo organ publik qendror që ka detyra dhe përgjegjësi në planifikimin e territorit, ose i janë deleguar detyra e përgjegjësi të caktuara për planifikimin e territorit dhe kontrollin mjedisor. Këto autoritete ushtrojnë funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse, që burojnë nga dhe/ose bazohen në legjislacionin në fuqi, për çështje të rëndësishë kombëtare të planifikimit të territorit. Sipas nenit 8 të ligjit, KKT-ja është organi vendimmarrës përgjegjës për miratimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit të territorit. Për sa u përket autoriteteve vendore të planifikimit, neni 12 i ligjit parashikon se ato janë bashkia/komuna, qarku dhe organet që janë në varësi të bashkisë/komunës/qarkut, të cilat ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në të gjithë territorin e tyre administrativ.

28. Përveç sa më sipër, ligji ka parashikuar edhe instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit, të cilat janë instrumente që miratohen e zbatohen nga autoritetet e planifikimit për të garantuar një interes publik. Një prej tyre është edhe pezullimi i zhvillimit, që nënkupton ndalimin e përkohshëm të zhvillimit ose shtyrjen e shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimi në të gjithë territorin ose në një pjesë të tij për një, disa ose çdo tip zhvillimi, në mënyrë që të ruhet territori në fjalë gjatë periudhës së hartimit të një instrumenti të planifikimit (neni 3, pika 39/a). Neni 63 i ligjit e ka përcaktuar pezullimin e zhvillimit si një ndër instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit në territor, të cilat zbatohen kur është i domosdoshëm realizimi i një qëllimi apo përdorimi publik të dokumentuar dhe kur rezulton të jetë metoda e vetme e përshtatshme për realizimin e tij. Sipas nenit 64, pezullimi i zhvillimit përdoret, në proporcion me rrethanat që e diktojnë atë, vetëm kur rezulton se instrumente të tjera në fuqi nuk do të jepnin një zgjidhje të përshtatshme. Autoriteti i planifikimit

mund të vendosë pezullimin e zhvillimit gjatë miratimit të nismës për hartimin e instrumentit të planifikimit ose gjatë procesit të hartimit të tij.

29. Në jurisprudencën kushtetuese, për çështje që kanë pasur për objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, Gjykata ka konkluduar se planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës janë kompetenca të plota dhe ekskluzive të autoriteteve vendore dhe përfshihen në konceptin ligjor “*funksionet e veta*”, sipas të cilit, nëpërmjet lirisë dhe autoritetit për të marrë vendime, ato janë përgjegjëse për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 29, datë 21.12.2006 dhe nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata rithekson se pezullimi i dhënies së lejeve zhvillimore konsiderohet *prima facie* një masë që ndërhyr në ushtrimin e funksioneve të autoriteteve vendore.

30. Gjykata ka theksuar se shumë çështje kanë implikime si vendore, ashtu edhe kombëtare dhe përgjegjësia për to ndryshon në hapësirë dhe në kohë dhe, për më tepër, kjo përgjegjësi mund të ndahet edhe ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Gjithsesi, kufizimi i veprimtarisë së autoriteteve vendore vetëm në çështje që nuk kanë implikime të gjera, mbart rrezikun për t'i shndërruar ato në autoritete me një rol të parëndësishëm. Nga ana tjetër, është e nevojshme që pushtetit qendror t'i rezervohen disa funksione të rëndësishme me rëndësi kombëtare e strategjike. Përcaktimi i interesit të komunitetit lidhet edhe me nevojën e ekzistencës së kufijve për vetë pushtetin vendor, i cili nuk duhet të tejkalojë kompetencat e tij duke vendosur për çështje që i përkasin një vendimmarrjeje të pastër politike ose për çështje që kanë pasoja ekonomike për të gjithë vendin dhe jo vetëm për komunitetin vendor përkatës. Është e lejueshme që çështje me rëndësi kombëtare e strategjike për interesat e vendit dhe që lidhen me miratimin e masterplaneve dhe të studimeve urbanistike rajonale e më gjerë, të ushtrohen nën autoritetin e pushtetit qendror, i cili është përgjegjës për politikën e zhvillimit ekonomik e politik të vendit. Megjithatë, do të konsiderohej si cenim i së drejtës për vetëqeverisje të pushtetit vendor, nëse ligjvënësi, duke u hequr kompetenca organeve vendore, do ta dobësonte aq shumë rolin e këtyre, saqë ekzistenca ose



vetëqeverisja e tyre do të bëheshin të pandjeshme (shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese).

31. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret vendimet e kundërshtuara nr. 1/2013 dhe nr. 3/2013 të KKT-së janë marrë në përputhje me parashikimet e sipërcituara të ligjit nr. 10119/2009. E drejta e pezullimit të zhvillimit është një kompetencë që ligji ia ka njohur autoritetit përkatës të planifikimit, i cili mund të jetë ai kombëtar apo vendor, në varësi të instrumentit të planifikimit. Sipas nenit 32 të ligjit, KKT-ja, me propozimin e AKPT-së, përcakton një çështje si të rëndësishme kombëtare në planifikim dhe dispozita përcakton edhe procedurën që ndiqet deri në miratimin e aktit, si dhe të drejtën e pezullimit, në bazë të nenit 64 të ligjit, në rastet kur ka një rrezik të qartë e emergjent ndaj interesave, karakteristikave apo funksioneve kombëtare të objektit ose të zonës, për të cilin propozohet përcaktimi si i rëndësishme kombëtare në planifikim. Në këtë kuptim, në rastin konkret, KKT-ja, si një nga autoritetet kombëtare të planifikimit dhe autoriteti përgjegjës për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, ka vendosur pezullimin e lejeve të zhvillimit në zona që janë vlerësuar se paraqesin rëndësi kombëtare në planifikim. Bazuar në parashtrimet e subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, Gjykata vëren se në rastin konkret arsyeja për miratimin e vendimeve objekt shqyrtimi është gjendja e emergjencës në territor, si pasojë e mungesës së kontrollit apo abuzimeve me pasuritë e vlerat e trashëgimisë ambientale, kulturore dhe historike, deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.

32. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarve për cenimin e parimeve të autonomisë vendore, të decentralizimit dhe proporcionalitetit të ndërhyrjes janë të pabazuara, pasi organi i pushtetit qendror ka ushtruar një kompetencë të tijën ligjore, në përputhje me përcaktimet e ligjit për planifikimin e territorit. Me anë të vendimeve të kundërshtuara, KKT-ja nuk ka ushtruar apo marrë asnjë kompetencë të cilën ligji ua ka njohur autoriteteve të qeverisjes vendore dhe që lidhet me menaxhimin dhe kontrollin e territorit në administrim. Ndërsa pezullimi i përkohshëm i dhënies së lejeve zhvillimore i referohet vetëm zonave me rëndësi të veçantë kombëtare,

Gjykata rithekson se edhe në rastin konkret në shqyrtim, organet e qeverisjes vendore nuk pengohen në ushtrimin e kompetencave në pjesën tjetër të territorit të tyre. Edhe pse pezullimi i dhënies së lejeve zhvillimore në disa zona të caktuara, sjell një pengesë të përkohshme në ushtrimin e funksioneve të organeve të qeverisjes vendore, kjo ndërhyrje është e justifikuar nga rëndësia e çështjes që rregullohet.

33. Kërkuarët kanë pretenduar, gjithashtu, se vendimet nr. 1/2013 dhe nr. 3/2013 të KKT-së janë në kundërshtim me nenin 64 të ligjit nr. 10119/2009, pasi sipas këtyre vendimeve afati i pezullimit është i papërcaktuar, ndërkohë që ligji ka parashikuar një afat maksimal prej 12 muajsh.

34. Gjykata vëren se bazuar në nenin 64/4 të ligjit nr. 10119/2009, pezullimi i zhvillimit mund të vendoset për një periudhë kohore deri në 12 muaj dhe ai mund të zgjatet edhe për 6 muaj të tjerë, për shkaqe specifike të përligjura. Në këto kushte, për sa kohë që afati brenda të cilit mund të zbatohet një instrument i tillë kontrolli i territorit, është parashikuar nga norma ligjore, fakti që ai nuk ka gjetur pasqyrim në vendimet e kundërshtuara, nuk e bën këtë akt të cenueshëm. Po ashtu, norma ligjore ka parashikuar se edhe në rastet kur pezullimi i zhvillimit qëndron në fuqi për një periudhë më të gjatë se 12 muaj, palët e prekura nga zbatimi i tij kanë të drejtë të kompensohen financiarisht në masën e humbjes apo dëmit të shkaktuar realisht nga zbatimi i këtij instrumenti (neni 64/5). Në këto kushte, edhe ky pretendim i kërkuarve është i pabazuar.

35. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesat e paraqitura nga Bashkia e Tiranës, Bashkia e Krujës dhe Komuna Katund i Ri Durrës, janë të pabazuara dhe, për pasojë, ato duhet të rrëzohen.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “ç” dhe 134, pika 1, shkronja “e” të Kushtetutës, si dhe neneve 54, 55, 56, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,



VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.⁶

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

KËRKESË

Nr. 705, datë 30.1.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Hidrocentrali i Banjës-Gramsh dhe Ura e Tashovicës".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit tokë bujqësore, truall dhe pyll.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është 27 689 550 (njëzet e shtatë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto**

⁶ Gjyqtari S. Berberi votoi për rrëzimin e kërkesës për mungesën e juridiksionit kushtetues me argumentin se kërkuesi, në thelb, kërkon kontrollin e ligjshmërisë së aktit individual të kundërshtuar, për të cilin, kërkuesi mund t'i drejtohet juridiksionit administrativ gjyqësor.



REBUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
"HIDROCENTRALI I BANJES-GRAMSH DHE URA E TASHOVICES"

Nr	Emri i pronarit	Zona Kadastr.	Numri Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Shënime
Fshati Kacivel, Komuna Tregan, Elbasan								
1	AQIF SHABAN KARAJ	2018	87/2	TOKE BUJQESORE	1113	271	301623	KONFIRMIM ZVRPP
2	DYLBER SHERIF MUÇA	2018	104/20	TOKE BUJQESORE	1746	271	473166	KONFIRMIM ZVRPP
3	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	161	PYLL	8807	85	748595	KONFIRMIM ZVRPP
4	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	89	TOKE BUJQESORE	176	271	47696	KONFIRMIM ZVRPP
5	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	89	TOKE BUJQESORE	1928	271	522488	KONFIRMIM ZVRPP
6	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	88	PYLL	1439	85	122315	KONFIRMIM ZVRPP
7	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	87/4	TOKE BUJQESORE	584	271	158264	KONFIRMIM ZVRPP
8	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	104/10	TOKE BUJQESORE	1262	271	342002	KONFIRMIM ZVRPP
9	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	104/11	TOKE BUJQESORE	1772	271	480212	KONFIRMIM ZVRPP
10	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	104/62	TOKE BUJQESORE	265	271	71815	KONFIRMIM ZVRPP
11	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	104/61	TOKE BUJQESORE	817	271	221407	KONFIRMIM ZVRPP
12	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	104/59	TOKE BUJQESORE	30	271	8130	KONFIRMIM ZVRPP
13	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	104/42	TOKE BUJQESORE	156	271	42276	KONFIRMIM ZVRPP
14	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	104/32	TOKE BUJQESORE	593	271	160703	KONFIRMIM ZVRPP
15	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	2018	104/36	TOKE BUJQESORE	309	271	83739	KONFIRMIM ZVRPP
16	GANI XHEMAL KARAJ	2018	104/60	TOKE BUJQESORE	373	271	101083	KONFIRMIM ZVRPP
17	GEZIM HAJDAR KARAJ	2018	104/35	TOKE BUJQESORE	1315	271	356365	KONFIRMIM ZVRPP
18	GEZIM HAJDAR KARAJ	2018	104/30	TOKE BUJQESORE	261	271	70731	KONFIRMIM ZVRPP
19	HALIT SHABAN KARAJ	2018	104/9	TOKE BUJQESORE	1466	271	397286	KONFIRMIM ZVRPP
20	HALIT SHABAN KARAJ	2018	118/15	TOKE BUJQESORE	3939	271	1067469	KONFIRMIM ZVRPP
21	KADRI ZENEL LLAPUSHI	2018	104/34	TOKE BUJQESORE	851	271	230621	KONFIRMIM ZVRPP
22	KADRI ZENEL LLAPUSHI	2018	124/6	TOKE BUJQESORE	1760	271	476960	KONFIRMIM ZVRPP
23	NEZIR ZYLAL LLAPUSHI	2018	118/13	TOKE BUJQESORE	1825	271	494575	KONFIRMIM ZVRPP
24	PA INFORMACION	2018	104/43	TOKE BUJQESORE	357	271	96747	KONFIRMIM ZVRPP
25	QEMAL SHAIK KARAJ	2018	104/21	TOKE BUJQESORE	711	271	192681	KONFIRMIM ZVRPP
26	RAMAZAN SHAIK KARAJ	2018	104/63	TOKE BUJQESORE	1115	271	302165	KONFIRMIM ZVRPP
27	REFAT SHABAN KARAJ	2018	87/3	TOKE BUJQESORE	1900	271	514900	KONFIRMIM ZVRPP
28	RIZA QAZIM KARAJ	2018	116/1	TOKE BUJQESORE	509	271	137939	KONFIRMIM ZVRPP
29	RIZA QAZIM KARAJ	2018	116/6	TOKE BUJQESORE	1390	271	376690	KONFIRMIM ZVRPP
30	SABRI BESHIR KARAJ	2018	104/18	TOKE BUJQESORE	443	271	120053	KONFIRMIM ZVRPP
31	SAMI RIZA KARAJ	2018	116/7	TOKE BUJQESORE	123	271	33333	KONFIRMIM ZVRPP
32	SAMI RIZA KARAJ	2018	116/5	TOKE BUJQESORE	552	271	149592	KONFIRMIM ZVRPP
33	XHEVIT SHAIK KARAJ	2018	104/64	TOKE BUJQESORE	650	271	176150	KONFIRMIM ZVRPP
34	XHEVIT SHAIK KARAJ	2018	114/1	TOKE BUJQESORE	1487	271	402977	KONFIRMIM ZVRPP
35	ZEQO ZENEL LLAPUSHI	2018	104/33	TOKE BUJQESORE	1300	271	352300	KONFIRMIM ZVRPP
Fshati Cingar Poshtem, Komuna Pishaj, Gramsh								
36	AGRON ALI ZOGU	3262	8/5	TOKE BUJQESORE	79	112	8848	KONFIRMIM ZVRPP
37	DYLBER SHAHIN ZOGU	3262	26/2	TOKE BUJQESORE	2676	112	299712	KONFIRMIM ZVRPP
38	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	3262	19/13	TOKE BUJQESORE	976	112	109312	KONFIRMIM ZVRPP
39	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	3262	22	TOKE BUJQESORE	105	112	11760	KONFIRMIM ZVRPP
40	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	3262	19/14	TOKE BUJQESORE	169	112	18928	KONFIRMIM ZVRPP
41	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	3262	48/65	TOKE BUJQESORE	5337	112	597744	KONFIRMIM ZVRPP
42	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	3262	53/2	TOKE BUJQESORE	946	112	105952	KONFIRMIM ZVRPP
43	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	3262	53/1	TOKE BUJQESORE	1358	112	152096	KONFIRMIM ZVRPP
44	METE+DHP UZUFUKT	3262	16/1	TOKE BUJQESORE	381	112	42672	KONFIRMIM ZVRPP
45	HYOMET QAMIL LAZI	3262	48/5	TOKE BUJQESORE	768	112	86016	KONFIRMIM ZVRPP
46	JAUP XHAFERR QOSJA	3262	48/3	TOKE BUJQESORE	41	112	4592	KONFIRMIM ZVRPP
47	MUSTAFA XHAFERR ZOGU	3262	8/4	TOKE BUJQESORE	626	112	70112	KONFIRMIM ZVRPP
48	NOVRUZ HASIM LAZI	3262	48/16	TOKE BUJQESORE	150	112	16800	KONFIRMIM ZVRPP
49	QANI RIZA ZOGU	3262	8/1	TOKE BUJQESORE	1971	112	220752	KONFIRMIM ZVRPP
50	SHKELQIM RIZA ZOGU	3262	8/2	TOKE BUJQESORE	2016	112	225792	KONFIRMIM ZVRPP
51	SERVET ALI ZOGU	3262	19/12	TOKE BUJQESORE	643	112	72016	KONFIRMIM ZVRPP
52	VUSHE HASIM ZOGU	3262	26/4	TOKE BUJQESORE	274	112	30688	KONFIRMIM ZVRPP
53	LUAN XHAFERR ZOGU	3262	8/3	TOKE BUJQESORE	670	112	75040	KONFIRMIM ZVRPP
Fshati Drize, Komuna Pishaj, Gramsh								
54	ANDREA DYLBER CARCIU	1556	83/2	TOKE BUJQESORE	817	175	142975	KONFIRMIM ZVRPP
55	ASLLAN RAMAZAN CARCIU	1556	32/5	TOKE BUJQESORE	152	175	26600	KONFIRMIM ZVRPP
56	DYLBER LIVAN CARCIU	1556	32/4	TOKE BUJQESORE	213	175	37275	KONFIRMIM ZVRPP



57	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	33	TOKE BUJQESORE	6172	175	1080100	KONFIRMIM ZVRPP
58	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	40	TOKE BUJQESORE	1000	175	175000	KONFIRMIM ZVRPP
59	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	83/11	TOKE BUJQESORE	544	175	95200	KONFIRMIM ZVRPP
60	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	83/12	TOKE BUJQESORE	182	175	31850	KONFIRMIM ZVRPP
61	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	83/13	TOKE BUJQESORE	337	175	58975	KONFIRMIM ZVRPP
62	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	83/15	TOKE BUJQESORE	506	175	88550	KONFIRMIM ZVRPP
63	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	83/16	TOKE BUJQESORE	378	175	66150	KONFIRMIM ZVRPP
64	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	82/7	TRUALL	1051	215	225965	KONFIRMIM ZVRPP
65	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	116/9	TRUALL	213	215	45795	KONFIRMIM ZVRPP
66	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	122/10	TOKE BUJQESORE	1161	175	203175	KONFIRMIM ZVRPP
67	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	122/10	TOKE BUJQESORE	629	175	110075	KONFIRMIM ZVRPP
68	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	122/13	TOKE BUJQESORE	100	175	17500	KONFIRMIM ZVRPP
69	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	143/21	TOKE BUJQESORE	20	175	3500	KONFIRMIM ZVRPP
70	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1556	143/18	TOKE BUJQESORE	232	175	40600	KONFIRMIM ZVRPP
71	HYOMET KAMBER ELEZI	1556	143/9	TOKE BUJQESORE	1732	175	303100	KONFIRMIM ZVRPP
72	ISLAM SHAQIR KULA	1556	143/32	TOKE BUJQESORE	785	175	137375	KONFIRMIM ZVRPP
73	HAJDAR KAMBER DRIZA	1556	116/1	TRUALL	523	215	112445	KONFIRMIM ZVRPP
74	KAMBER RIZA KULA	1556	143/16	TOKE BUJQESORE	1605	175	280875	KONFIRMIM ZVRPP
75	KOCI AJAZ ELEZI	1556	83/17	TOKE BUJQESORE	276	175	48300	KONFIRMIM ZVRPP
76	KODHEL ZENEL ELEZI	1556	122/14	TOKE BUJQESORE	155	175	27125	KONFIRMIM ZVRPP
77	KUTTIM GANI ELEZI	1556	122/15	TOKE BUJQESORE	705	175	123375	KONFIRMIM ZVRPP
78	LAHE ZENUN CARCIU	1556	122/11	TOKE BUJQESORE	239	175	41825	KONFIRMIM ZVRPP
79	MAKSUT YMER DRIZA	1556	143/21	TOKE BUJQESORE	20	175	3500	KONFIRMIM ZVRPP
80	MERSIN LIVAN CARCIU	1556	32/1	TOKE BUJQESORE	292	175	51100	KONFIRMIM ZVRPP
81	MERSIN LIVAN CARCIU	1556	83/4	TOKE BUJQESORE	450	175	78750	KONFIRMIM ZVRPP
82	MUHAMMAD RIZA KULA	1556	143/15	TOKE BUJQESORE	928	175	162400	KONFIRMIM ZVRPP
83	MUSTAFA RIZA KULA	1556	143/17	TOKE BUJQESORE	1016	175	177800	KONFIRMIM ZVRPP
84	NEVRUS HALIL CARCIU	1556	32/8	TOKE BUJQESORE	128	175	22400	KONFIRMIM ZVRPP
85	PELLUMB FEIM CARCIU	1556	32/3	TOKE BUJQESORE	267	175	46725	KONFIRMIM ZVRPP
86	PELLUMB FEIM CARCIU	1556	20/5	TOKE BUJQESORE	788	175	137900	KONFIRMIM ZVRPP
87	PELLUMB FEIM CARCIU	1556	83/5	TOKE BUJQESORE	492	175	86100	KONFIRMIM ZVRPP
88	PETRIT NEZIR CARCIU	1556	120/1	TOKE BUJQESORE	272	175	47600	KONFIRMIM ZVRPP
89	PETRIT XHELO SADIKU	1556	20/3	TOKE BUJQESORE	356	175	62300	KONFIRMIM ZVRPP
90	PETRIT XHELO SADIKU	1556	83/7	TOKE BUJQESORE	759	175	132825	KONFIRMIM ZVRPP
91	SELIM MERSIN CARCIU	1556	83/3	TOKE BUJQESORE	390	175	68250	KONFIRMIM ZVRPP
92	SELIM MERSIN CARCIU	1556	32/2	TOKE BUJQESORE	466	175	81550	KONFIRMIM ZVRPP
93	SHEFKI MERSIN CARCIU	1556	83/1	TOKE BUJQESORE	495	175	86625	KONFIRMIM ZVRPP
94	SHKELQIM HALIL CARCIU	1556	32/9	TOKE BUJQESORE	676	175	118300	KONFIRMIM ZVRPP
95	SHKELQIM HALIL CARCIU	1556	38	TOKE BUJQESORE	258	175	45150	KONFIRMIM ZVRPP
96	SKENDER HARUN SHYTYLLA	1556	20/2	TOKE BUJQESORE	495	175	86625	KONFIRMIM ZVRPP
97	XHAFER REFAT KULA,TUFE NAZIR KULA,NAZE ZENUN	1556	143/8	TOKE BUJQESORE	410	175	71750	KONFIRMIM ZVRPP
Fshati Cerruje, Komuna Pishaj, Gramsh								
98	AGIM HASAN Tafa	1392	63/13	TOKE BUJQESORE	221	175	38675	KONFIRMIM ZVRPP
99	AQIF METUSH LIKA	1392	63/3	TOKE BUJQESORE	362	175	63350	KONFIRMIM ZVRPP
100	BEQO DULE ZANI	1392	63/9	TOKE BUJQESORE	332	175	58100	KONFIRMIM ZVRPP
101	BESIM ISUF BOJA	1392	63/5	TOKE BUJQESORE	240	175	42000	KONFIRMIM ZVRPP
102	BEXHET ALI TRIMI	1392	63/6	TOKE BUJQESORE	216	175	37800	KONFIRMIM ZVRPP
103	BEXHET ISLAM DEDE	1392	66/15	TOKE BUJQESORE	386	175	67550	KONFIRMIM ZVRPP
104	BEXHET ISLAM DEDE	1392	70/10	TOKE BUJQESORE	665	175	116375	KONFIRMIM ZVRPP
105	DEMIR SHABAN KOTORRI	1392	66/13	TOKE BUJQESORE	342	175	59850	KONFIRMIM ZVRPP
106	DURIM DULE CEKREZI	1392	66/11	TOKE BUJQESORE	374	175	65450	KONFIRMIM ZVRPP
107	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1392	70/17	TOKE BUJQESORE	1550	175	271250	KONFIRMIM ZVRPP
108	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1392	27/2	TOKE BUJQESORE	126	175	22050	KONFIRMIM ZVRPP
109	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1392	65/3	TOKE BUJQESORE	59	175	10325	KONFIRMIM ZVRPP
110	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1392	27/24	TOKE BUJQESORE	20	175	3500	KONFIRMIM ZVRPP
111	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1392	71/31	TOKE BUJQESORE	799	175	139825	KONFIRMIM ZVRPP
112	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1392	40/1	TOKE BUJQESORE	1125	175	196875	KONFIRMIM ZVRPP
113	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1392	71/32	TOKE BUJQESORE	1528	175	267400	KONFIRMIM ZVRPP
114	EDMOND SHABAN MIRAKA	1392	63/4	TOKE BUJQESORE	346	175	60550	KONFIRMIM ZVRPP
115	ELTON NAZIF MURATI	1392	70/16	TOKE BUJQESORE	700	175	122500	KONFIRMIM ZVRPP
116	ELTON NAZIF MURATI	1392	71/40	TOKE BUJQESORE	1001	175	175175	KONFIRMIM ZVRPP
117	ELTON NAZIF MURATI	1392	66/16	TOKE BUJQESORE	441	175	77175	KONFIRMIM ZVRPP
118	FATUSHE DULE CEKREZI	1392	63/17	TOKE BUJQESORE	40	175	7000	KONFIRMIM ZVRPP
119	FERDINANT SYRJA KOFSHA	1392	27/22	TOKE BUJQESORE	1340	175	234500	KONFIRMIM ZVRPP
120	HYSNI MAKSUT KOVACI	1392	29/9	TOKE BUJQESORE		175	0	KONFIRMIM ZVRPP
121	IKE BARJAM Tafa	1392	63/12	TOKE BUJQESORE	252	175	44100	KONFIRMIM ZVRPP
122	ILIR HETEM SENEJA	1392	27/6	TOKE BUJQESORE	450	175	78750	KONFIRMIM ZVRPP
123	ILIR HETEM SENEJA	1392	63/7	TOKE BUJQESORE	228	175	39900	KONFIRMIM ZVRPP
124	ILIR HETEM SENEJA	1392	27/7	TOKE BUJQESORE	319	175	55825	KONFIRMIM ZVRPP
125	IRMA SHEFOET JAHU	1392	27/1	TOKE BUJQESORE	1605	175	280875	KONFIRMIM ZVRPP
126	JANI SABRI CEKREZI	1392	70/12	TOKE BUJQESORE	3171	175	554925	KONFIRMIM ZVRPP
127	KLODIAN SHAP MURATI	1392	71/36	TOKE BUJQESORE	748	175	130900	KONFIRMIM ZVRPP
128	KUTTIM DULE CEKREZI	1392	63/16	TOKE BUJQESORE	98	175	17150	KONFIRMIM ZVRPP
129	MURAT ISLAM DEDE	1392	66/14	TOKE BUJQESORE	302	175	52850	KONFIRMIM ZVRPP



130	MURAT ISLAM DEDE	1392	70/11	TOKE BUJQESORE	1869	175	327075	KONFIRMIM ZVRPP
131	MURAT SHABAN KOTORRI	1392	66/12	TOKE BUJQESORE	450	175	78750	KONFIRMIM ZVRPP
132	NAZIF ABEDIN MURATI	1392	71/23	TOKE BUJQESORE	661	175	115675	KONFIRMIM ZVRPP
133	NAZMI ISLAM DEDE	1392	72/9	TOKE BUJQESORE	974	175	170450	KONFIRMIM ZVRPP
134	NAZMI ISLAM DEDE	1392	66/18	TOKE BUJQESORE	30	175	5250	KONFIRMIM ZVRPP
135	NAZMI ISLAM DEDE	1392	71/21	TOKE BUJQESORE	334	175	58450	KONFIRMIM ZVRPP
136	RAMAZAN HASAN Tafa	1392	63/11	TOKE BUJQESORE	318	175	55650	KONFIRMIM ZVRPP
137	RAMIZ ESTREF RABO	1392	63/15	TOKE BUJQESORE	153	175	26775	KONFIRMIM ZVRPP
138	SABRI ISLAM MEDI	1392	71/33	TOKE BUJQESORE	368	175	64400	KONFIRMIM ZVRPP
139	SALI SHABAN BOJA	1392	63/26	TOKE BUJQESORE	881	175	154175	KONFIRMIM ZVRPP
140	SEIT MERSIN KOLLCAKU	1392	63/8	TOKE BUJQESORE	225	175	39375	KONFIRMIM ZVRPP
141	SHAIP ABEDIN MURATI	1392	71/37	TOKE BUJQESORE	325	175	56875	KONFIRMIM ZVRPP
142	SHAIP ABEDIN MURATI	1392	66/17	TOKE BUJQESORE	441	175	77175	KONFIRMIM ZVRPP
143	SHAZO HAMIT BALLABANI	1392	29/8	TOKE BUJQESORE	2086	175	365050	KONFIRMIM ZVRPP
144	SHEFIT BRAHUSH MIRAKA	1392	27/23	TOKE BUJQESORE	183	175	32025	KONFIRMIM ZVRPP
145	SHEFQET XHAHER GJYLA	1392	63/14	TOKE BUJQESORE	160	175	28000	KONFIRMIM ZVRPP
146	SKENDER JONUS BRAZHDI	1392	65/1	TOKE BUJQESORE	798	175	139650	KONFIRMIM ZVRPP
147	XHEMILE DEMIR BOJA	1392	63/2	TOKE BUJQESORE	454	175	79450	KONFIRMIM ZVRPP
148	YZEIR SALI DOBRENJI	1392	63/10	TOKE BUJQESORE	183	175	32025	KONFIRMIM ZVRPP
Fshati Qerret, Komuna Pishaj, Gramsh								
149	AGRON FASLI HASA	3103	81/4	TOKE BUJQESORE	299	175	52325	KONFIRMIM ZVRPP
150	ALI NEVRUZ SHULI	3103	76/4	TOKE BUJQESORE	785	175	137375	KONFIRMIM ZVRPP
151	ARTAN BRAHUSH DERMYSHI	3103	81/9	TOKE BUJQESORE	605	175	105875	KONFIRMIM ZVRPP
152	ASTRIT FAK BALOSHI	3103	81/5	TOKE BUJQESORE	401	175	70175	KONFIRMIM ZVRPP
153	BUJAR NEIM MATO	3103	98/21	TOKE BUJQESORE	2520	175	441000	KONFIRMIM ZVRPP
154	DEFRIM MALIQ HOXHA	3103	102/4	TOKE BUJQESORE	1024	175	179200	KONFIRMIM ZVRPP
155	DERVISH SHAIP LLAPUSHI	3103	126/5	TOKE BUJQESORE	2401	175	420175	KONFIRMIM ZVRPP
156	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	3103	76/3	TOKE BUJQESORE	827	175	144725	KONFIRMIM ZVRPP
157	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	3103	77	TOKE BUJQESORE	418	85	35530	KONFIRMIM ZVRPP
158	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	3103	81/3	TOKE BUJQESORE	250	175	43750	KONFIRMIM ZVRPP
159	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	3103	98/21	TOKE BUJQESORE	286	175	50050	KONFIRMIM ZVRPP
160	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	3103	98/22	TOKE BUJQESORE	1341	175	234675	KONFIRMIM ZVRPP
161	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	3103	99/5	TOKE BUJQESORE	696	175	121800	KONFIRMIM ZVRPP
162	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)+METE ADMINISTRIM	3103	127/1	TOKE BUJQESORE	345	175	60375	KONFIRMIM ZVRPP
163	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)+METE ADMINISTRIM	3103	143/3	TOKE BUJQESORE	482	175	84350	KONFIRMIM ZVRPP
164	ENVER ALI SHULI	3103	76/6	TOKE BUJQESORE	553	175	96775	KONFIRMIM ZVRPP
165	FAIK LIKO BALOSHI	3103	102/2	TOKE BUJQESORE	687	175	120225	KONFIRMIM ZVRPP
166	HEKURAN PASHO BRAHIMI	3103	102/6	TOKE BUJQESORE	87	175	15225	KONFIRMIM ZVRPP
167	MURAT ALI SHULI	3104	76/5	TOKE BUJQESORE	708	175	123900	KONFIRMIM ZVRPP
168	NEVRUZ XHAHER GJYLA	3105	81/6	TOKE BUJQESORE	184	175	32200	KONFIRMIM ZVRPP
169	PETRIT QEMAL HOXHA	3106	81/2	TOKE BUJQESORE	361	175	63175	KONFIRMIM ZVRPP
170	QAMIL MUSTAFA Tafa	3107	76/2	TOKE BUJQESORE	913	175	159775	KONFIRMIM ZVRPP
171	RAMADAN LIKO BALOSHI	3108	102/1	TOKE BUJQESORE	1706	175	298550	KONFIRMIM ZVRPP
172	RAZIE VESEL HOXHA	3109	102/5	TOKE BUJQESORE	458	175	80150	KONFIRMIM ZVRPP
173	SEJAT ZENEL KISHTA	3110	81/8	TOKE BUJQESORE	1131	175	197925	KONFIRMIM ZVRPP
174	SEJAT ZENEL KISHTA	3111	98/2	TOKE BUJQESORE	126	175	22050	KONFIRMIM ZVRPP
175	SELIM ARIF BUZALI	3112	98/3	TOKE BUJQESORE	352	175	61600	KONFIRMIM ZVRPP
176	SHABAN TEME TOROMANI	3113	99/1	TOKE BUJQESORE	710	175	124250	KONFIRMIM ZVRPP
177	SHERIF TEME TOROMANI	3103	99/6	TOKE BUJQESORE	89	175	15575	KONFIRMIM ZVRPP
178	SHYQYRI BAJRAM KUMRIA	3103	98/18	TOKE BUJQESORE	1388	175	242900	KONFIRMIM ZVRPP
179	TAJAR HEKUR BAKU	3103	126/7	TOKE BUJQESORE	1444	175	252700	KONFIRMIM ZVRPP
180	TAJAR HEKUR BAKU	3103	101/3	TOKE BUJQESORE	92	175	16100	KONFIRMIM ZVRPP
181	XHEZARE SHABAN Tafa	3103	75/1	TOKE BUJQESORE	54	175	9450	KONFIRMIM ZVRPP
182	XHEZARE SHABAN Tafa	3103	76/1	TOKE BUJQESORE	531	175	92925	KONFIRMIM ZVRPP
183	ZADE MEHMET HOXHA	3103	102/3	TOKE BUJQESORE	738	175	129150	KONFIRMIM ZVRPP
Fshati Cekin, Komuna Pishaj, Gramsh								
184	BARDHUL QANI LLAPUSHI	1362	1/3	TOKE BUJQESORE	917	175	160475	KONFIRMIM ZVRPP
185	ISUF HAJDIN TRIMI	1362	1/7	TOKE BUJQESORE	493	175	86275	KONFIRMIM ZVRPP
186	RIZA YLLI POTOMI	1362	52/7	TOKE BUJQESORE	41	175	7175	KONFIRMIM ZVRPP
187	EQEREM ALI BLOGU	1362	52/6	TOKE BUJQESORE	215	175	37625	KONFIRMIM ZVRPP
188	SHYQYRI RIZA BLOGU	1362	52/5	TOKE BUJQESORE	86	175	15050	KONFIRMIM ZVRPP
189	BASHKIM RIZA BLOGU	1362	52/4	TOKE BUJQESORE	85	175	14875	KONFIRMIM ZVRPP
190	HYSEN RIZA BLOGU	1362	52/3	TOKE BUJQESORE	87	175	15225	KONFIRMIM ZVRPP
191	SKENDER RIZA BLOGU	1362	52/2	TOKE BUJQESORE	61	175	10675	KONFIRMIM ZVRPP
192	BEKTASH RIZA BLOGU	1362	52/1	TOKE BUJQESORE	6	175	1050	KONFIRMIM ZVRPP
193	BEXHET JASHAR KOLA	1362	63/1	TOKE BUJQESORE	565	175	98875	KONFIRMIM ZVRPP
194	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1362	6/58	TOKE BUJQESORE	292	175	51100	KONFIRMIM ZVRPP
195	E PAIDENTIFIKUAR (SHTET)	1362	63/2	TOKE BUJQESORE	22	175	3850	KONFIRMIM ZVRPP
Fshati Pishaj, Komuna Pishaj, Gramsh								
196	SHIPEND ISLAM TABAKU	3624	44/1	TOKE BUJQESORE	430	175	75250	KONFIRMIM ZVRPP
LOLVIT								
Më 125021								
51'000'220'00								
TEKE								
100	SHILEJI	3054	48/4	BAIT	1201	82	135082	KOINBIMIN SARBB
108	KODIVIN WELI2H KVMV	3054	44/38	LOKE BMOE20KE	1100	132	503000	KOINBIMIN SARBB
103	DOTE WEMIN LVILEI	3054	44/5	LOKE BMOE20KE	330	132	00352	KOINBIMIN SARBB

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10521, datë 26.1.2015, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Sami Muharremi, i

biri i Hysenit dhe i Shemes, i datëlindjes 31.12 1918, lindur në Filat, duke përcaktuar si datë të vdekjes së tij, datën 1.1.1999 dhe si vend të vdekjes së tij, Zall-Herr, Tiranë.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë